

MONITORIMI DHE VLERESIMI I ARSIMIT SHQIPTAR

ORGANIZATORET:

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES, QENDRA KOMBETARE E VLERESIMIT,
AEDP/SOROS**

FINANCUAR NGA: AEDP/SOROS - EAST EAST PROGRAM

6-7 December 2001

**Me pjesemarrjen e eksperteve nga Republika Çeke,
Maqedonia, Mali Zi dhe Kosova.**

Tema e Seminarit

Sokol Axhemi, Zv. Minister i Arsimit

Te nderuar miq,
Te nderuar pjesemarres,

Eshte nje kenaqesi te jemi sot se bashku dhe t'i ofroj komplimentet e mija organizatoreve te ketij seminari (MASH, Qendres Kombetare te Vleresimit dhe AEDP) si dhe bashkefinancuesve te tij (East East Program & AEDP).

Ky seminar eshte ne rrjedhen e ndryshimeve qe po ndodhin ne sistemin arsimor shqiptar. Nga ana tjeter, shoqeria kerkon qe shkolla te edukojne te gjitha nxenesit, jo vetem te talentuarit, ne nivele te tilla qe i aftesojne ata te perballojne sfidat e jetes qe i pret. Punonjesit e ardhshem te Shqiperise duhet te jene te afte te komunikojne ide komplekse, te ambjentohen shpejt me arritjet e shkences dhe te teknologjise, te zgjidhin problemet me te cilat ata do te ndeshen ne jeten e tyre.

Pra, kerkesat shoqerore, ekonomike dhe politike kerkojne ndryshime ne arsim ne menyre qe te rritet kapaciteti i sistemit arsimor. Por, keto ndryshime krijojne nje hendek midis kerkesave te shoqerise ndaj arsimit dhe rezultateve te tij. Keshtu, te gjitha jemi te ndergjegjshem se ai vuan nga te meta serioze: rruge dhe struktura te vjetra me modele punesimi, kompensimi dhe vleresimi qe kane pak te bejne me mesimdhenien e mire.

Ne kompleksitetin e problemeve qe qendrojne para sistemit tone arsimor, vleresimi dhe monitorimi perbejne nje prioritet. Sepse ato perfaqesojne nje nga fushat ku dobesite jane te dukshme. Natyrisht, ndryshime ka. Pranimet e studenteve ne universitet nepermjet konkurseve perbejne nje hap te madh. Ngritja e Qendres Kombetare te Vleresimit shenon fillimin e institucionalizimit te institucioneve vleresuese. Por, realiteti ka probleme te medha per t'u zgjidhur. Keshtu, vleresimi i arritjeve eshte sporadik; ne shumicen e rasteve ai kryhet nga drejtoret e shkollave pervoja mesimore e te cileve nuk eshte e te njejtës fushe me ate te mesuesit qe vleresohet, etj.

Problematika e problemeve qe trajtohen ne kete seminar kerkon te jap nje tablo te problemeve ne fushen e monitorimit dhe te vleresimit te arsimit ne vendin tone.

Tradicionalisht, normat e vendosura nga ministrite e arsimit kane trajtuar inputet ne sistemin shkollor: sa mesuese per sa nxenes, tipet e pajisjeve shkollore, buxheti i kerkuar? Keto norma kane synuar te sigurojne pajisjen e shkolles ne menyre te tille qe te siguroheshin mundesite e nevojshme per arsimin e te gjitha nxenesve. Ne shume vende, autoritetet shkuan nje hap me tej duke specifikuar permbajtjen qe duhet pervetesuar dhe duke hartuar te njeten kurrikule per te gjitha nxenesit e shkolles fillore. Nderkaq, per shume vende kurrikulua u detajua te zbatohet ne kuadrin e oreve mesimore (ne Shqiperi ore e mesimit eshte 45 minuta).

Megjithate, gjate viteve 1960 dhe 1970 situata filloi te ndryshoje gradualisht. Se pari, ministrite e arsimit ne shume vende vendosen te inkurajojne fleksibilitetin dhe pergjegjesine e sistemeve shkollore ne kuptimin e inputit, mundesive dhe te rregullimeve te permbajtjes. Por me shume se fokusi ne normat e inputit, shume vende e drejtuan vemendjen tek specifikimi i objektivave te arsimit dhe vendosja e standardeve te arritjes per mesueset, nxenesit, shkollat dhe sistemin ne teresi.

Natyrisht, para se te vendosen standardet e arritjes, duhet vendosur se ç'duhet te njohin nxenesit dhe ç'jane te afte te kryejne. Por, nje vendim per ate qe duhet te mesojne dhe te zoterojne nxenesit presupozon nje consensus per synimet, objektivat dhe detyrat e arsimimit. Sapo te jene percaktuar synimet dhe standardet, hapi i mepasshem eshte marrja e te dhenave per shkallen e arritjes se tyre. Nje gje e tille kerkon mbledhjen e te dhenave per vleresimin e arritjes dhe monitorimin e progresit arsimor. Por, çdo analize te dhenash nuk eshte e plote dhe mund te jap rezultate te gabuara nese nuk merren parasysh kontekstet, inputet dhe proceset e shkollimit. Siç shihet, interpretimi i te dhenave te vleresimit ka si parakusht mbledhjen dhe analizen e informacionit ne disa fusha dhe ne disa nivele te sistemit arsimor.

Theksi tek rezultatet perfaqeson nje ndryshim radikal ne lidhje me menyren tradicionale te mbledhjes se te dhenave per burimet e menaxhimit dhe planifikimin arsimor. Tani kerkohen role te reja per te gjithë aktoret: nxenesit, mesueset dhe drejtoret e shkollave, nivelet qendrore dhe locale te administrimit te arsimit, inspektoriateve, agjensive pergjegjese per mbledhjen e te dhenave statistikore per sistemet shkollore si dhe per planifikueset dhe vendimarrësit e arsimit.

Keto jane pak a shume idete qe pershkojne punimet e ketij seminari. Arsimi shqiptar duhet te ece shpejt per t'u perfshtire ne rrjedhat moderne te zhvillimeve arsimore. MASH, Qendra Kombetare e Vleresimit dhe AEDP po punojne intensivisht ne nje sere drejtimesh. Fillimisht u hartua nje Manual i Treguesve Sasiore te shkolles. Duke qene nje mjet i fuqishem per analizen e proceseve arsimore ne nivel shkolle, ai krijoi kushtet per hartimin e nje seti te plote te treguesve arsimore per te tre nivelet e sistemit tone arsimor. Ky set indikatorësh eshte konsultuar me institucione presitgjiore nderombetare si: CITO, Universiteti i Tel Avivit, etj. Nderkaq, sistemi yne arsimor eshte perfshtire per here te pare ne nje vleresim nderkombetar: Programi PISA/OECD. Ne kete menyre, veç ballafaqimit me kerkesa nderkombetare, vlere e kesaj pjesemarrjeje konsiston: ndryshime te pritshme ne kurrikulen e shkolles sone dhe nje pervoje e paçmuar ne organizimin e vleresimeve te tilla masive.

Paralelisht, ne po punojme per te perfshtire sistemin tone arsimor ne botimet e organizmave te njohura nderkombetare. Eshte identifikuar nje grup i pare indikatorësh te cilet do te perfaqesojne arsimin shqiptar ne keto botime. Ne kete menyre, ne do te kemi ne duar nje informacion te vlefshem dhe te besueshem per te bere krahasime me sisteme arsimore te vendeve te tjera, duke hedhur hapa konkrete per afrimin e sistemit arsimor shqiptar me ato te perparuara.

Ky eshte konteksti i ketij seminari. Nepermjet punimeve mbi standardt synohet te komunikohet nje vizion i perbashket per ate qe duhet te njohin mesueset dhe te jene te

afte te kryejne ne punen e tyre. Ndersa, nepermjet punimeve per indikatoret synohet te krijohen vleresime te besueshme dhe te vlefshme te lendeve mesimore dhe te shkollave, vleresime te cilat perbejne pervoja te fuqishme mesimore per mesueset. Me mjaft deshire presim te degjojme ekspertet e ftuar nga Çekia, Mali ZI, Maqedonia dhe Kosova. Besoj se pajtohemi me idene qe tradita jone arsimore pothuajse eshte e njejte dhe tipike per kete pjese te Europes ku ndodhen vendet tona. Kemi shume probleme te perbashketa, zgjidhja e te cileve do te lehtesohej nga bashkeveprim midis nesh. Prandaj do te uroja qe, ne te gjithë, te gjenim rruget qe lehtesojne bashkepunimin midis nesh per te rritur cilesine e arritjeve te sistemeve tona arsimore.

Vleresimi ne shkalle te gjere dhe politika arsimore ne Shqiperi

Në një epokë në të cilën arsimit është një nga preokupimet kryesore të çdo shteti përpunimi i treguesve arsimorë të nevojshëm dhe të besueshëm bëhet esencial në formulimin dhe monitorimin e politikave në këtë fushë. Bota e punës kërkon gjithmonë e më shumë kualitete intelektuale, ndërsa njekohësisht ndodh që vjen duke u rritur sasia e njohjes. Konkurenca dhe bashkëpunimi ekonomik hapin para vendeve të ndryshme mundësinë për të fuqizuar efikasitetin dhe produktivitetin e sistemeve të tyre të arsimit.

Këto zhvillime po i shtyjnë drejtuesit politikë të arsimit për të kërkuar nëse në vendet e tyre kapacitetet e të rinjve janë si nga ana cilësore dhe ajo sasiore të mjaftueshme. Ata duan të dinë se në çfarë mase është realizuar një progres arsimor dhe si janë sistemet e tyre të arsimit në lidhje me ato të vendeve të tjera. Keto informacione shërbejnë për të mbajtur në korent opinionin publik, për të drejtuar në mënyrë shkencore dhe efikase

përmirësimin e shkollës, për të ndihmuar në përcaktimin e përparësive dhe për të përcaktuar më mirë përgjegjësitë politike në fushën e arsimit në të gjitha nivelet e drejtimit të tij.

Këto informacione nuk mund të përgjithësohen për të mirë nga drejtuesit politikë, nëse sistemet e arsimit nuk mund të monitorohen në kohën e duhur dhe sistematikisht dhe nëse informacionet e marra, përsa i takon sistemeve, të mund të krahasohen në nivel ndërkombëtar. Për këtë treguesit duhet të zhvillohen në nivelet më sinjifikative të sistemeve të arsimit: shkolla, rajoni, vendi i tërë ose sistemi kombëtar si dhe niveli ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, hap pas hapi, nga prodhimi i sistemeve kombëtare të informacionit arrihet në mundësinë që ato të bëhen të krahasueshme në nivel ndërkombëtar ç'ka do të rrisë interesin për një bashkëpunim më të frytshëm në këtë nivel.

Në këtë kontekst AEDP po mbështet një studim, i cili në themel të tij ka përcaktimin e një tërësie të të dhënave bazë “sasiorë” dhe “cilësore” në nivel shkolle, për të kaluar pastaj hap pas hapi në nivelet më të larta dhe pikërisht në nivel rajonal e më tej në prodhimin e sistemeve kombëtare. Grupi i punës përbëhet kryesisht nga ekspertë të Institutit të Studimeve Pedagogjike, të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, drejtorë shkollash, etj. Puna është ndarë në dy pjesë: Fillimisht u eksperimentuan treguesit “sasiorë” dhe mbi këtë bazë është përgatitur një manual i cili paraqit të dhënat statistikore, organizimin e tyre në tabela të caktuara për të rritur komoditetin e paraqitjes dhe gjithashtu të përdorimit të tyre me lehtësi. Gjithashtu ky manual përmban mënyrat e interpretimit dhe përdorimit të këtyre tabelave për të analizuar situata të caktuara e për të nxjerrë përfundime. Grupi ka filluar punën për përgatitjen edhe të treguesve “cilësorë” duke u mbështetur në përvojën tonë dhe të disa vendeve të botës. Me mbështetjen financiare të Bankës Botërore dhe të AEDP (50% me 50%), grupi për të parë përvojën në disa vende të botës do të bëjë disa vizita: në Liban, Hungari, OECD Paris dhe në Kembrixh, Angli.

Për të arritur në përfundimet që do të paraqiten në këtë manual (manuali nr.1 për treguesit “sasiorë”) është shfrytëzuar përvoja e deritanishme nga organet e arsimit si dhe përvoja të ndryshme të studimit e të punës konkrete të specialistëve të arsimit të kësaj fushe, të drejtorëve të disa shkollave etj. Gjithashtu është shfrytëzuar edhe përvoja ndërkombëtare si për të marrë nga ajo gjëra e parametra të papërdorur më parë në Shqipëri ashtu edhe për të demonstruar mundësinë për të realizuar dhe për të përcaktuar tregues të arsimit që janë të krahasueshëm në nivel ndërkombëtar.

Të gjitha këto hapa do të kontribuojnë për të përcaktuar qartë metodat e vlerësimit, duke përpunuar treguesit arsimorë dhe ndihmuar për të kuptuar përdorimin, ndërveprimin dhe kufijtë e përdorimit të tyre. Krahasimi dhe burimi ndërkombëtar është marrë nga OECD (Organizata për bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik me qendër në Paris), Birzea, Skocia, Hollanda, SHBA (grup shtetesh), SHBA (Shteti Indiana). Një grup ekspertësh vizitoi nga fundi i vitit 1997 Hollandën (sipas rekomandimeve të OECD, si një shtet që dallohet në rritjen e OECD për një punë më specifike në përcaktimin dhe përdorimin e të dhënave bazë në nivel shkolle).

Është filluar nga shkolla pasi sot të gjitha përpjekjet që bëhen nëpërmjet programeve për përmirësimin e shkollave si një mënyrë për ndryshime arsimore, e vendosin shkollën në qendër të këtyre ndryshimeve. Ajo është një lëvizje brenda komunitetit të shkollës ku shkolla:

- Përcakton vizionin dhe ndërton strategji për arritjen e objektivave të saj (në linjë me drejtimin e përgjithshëm të reformës);
- Synon në rritjen e rezultateve të nxënësve dhe fokusohet tek mësimdhënia dhe mësimnxënia;
- Trajton kushtet e brendshme dhe të jashtme që rrisin ndryshimet;
- Monitoron dhe vlerëson procesin, progresin dhe arritjet.

Përmirësimi i shkollës është një strategji që forcon aftësinë e shkollës për t'i bërë ballë ndryshimeve dhe për të krijuar struktura efektive dhe fleksibile për përgatitjen sa më të mirë të nxënësve. Një shkollë e angazhuar në një lëvizje përmirësimi bëhet një organizatë që mendon, reflekton dhe mëson dhe që përpiqet për të siguruar një arsim cilësor se sa thjesht të pranojë në frymë jo kritike direktivat nga lart. Përmirësimi i shkollës është detyrë e çdo shkolle. Ndryshimet lipset të fillojnë nga brenda shkollës por është e nevojshme dhe mbështetja e jashtme.

Koncepti i përmirësimit dhe efektivitetit të shkollës ka filluar të diskutohet në Perëndim qysh në vitet 60. Në vitet 80 pasi metodat nga lart-poshtë për reformimin e arsimit dështuan në shumë vende Perëndimore, metodat e reja nxitën si metodat nga lart-poshtë ashtu dhe ato nga poshtë-lart dhe theksuan rëndësinë e angazhimit të mësuesve dhe komunitetit të shkollës në përpjekje për reformën arsimore. Në vendet Perëndimore shkollat i nënshtrohen “trugës së ndryshimeve”, marrin mbështetje profesionale nga shteti, institucionet dhe universitetet shtetërore rajonale si dhe nga qendrat për përmirësimin e shkollave. Ndërsa në Europën Qendrore dhe Lindore nuk ka ndonjë institucion arsimor që mund ta trajtojë shkollën si një organizëm të tërë, kompleks dhe homogjen ku të gjitha komponentet të lidhen ngushtë. Në shumë vende të rritit, Fondacionet Soros janë përpjekur që të ndër marrin, mbështesin dhe çojnë përpara lëvizje për përmirësimin e shkollave.

Në të kaluarën kriteri kryesor për gjykimin e shkollave ishin arritjet e nxënësve në një aspekt të veçantë të zhvillimit të tyre, kryesisht nëpërmjet nivelit të dijeve faktike të fituara. Kjo ndodh edhe sot. Tani shkollat në “përmirësim” përpiqen të theksojnë anët e tjera të zhvillimit të nxënësve, veçanërisht aftësitë dhe vlerat. Një shoqëri që ndryshon me shpejtësi parashtron kërkesa të reja për shkollat: ato duhet t'i përgatisin nxënësit për të mësuar gjatë gjithë jetës se sa të përpiqen për t'i dhënë përgjigje çdo pyetjeje.

Dijet faktike janë akoma të rëndësishme, por më pak të rëndësishme se sa përpara sepse ka edhe aspekte të tjera që duhen gjykuar, megjithëse shpesh ato janë më të vështira për t'u vlerësuar objektivisht. Në vlerësimin e efektit të përmirësimit të shkollës, dikush do të donte ndoshta të testonte njohuritë faktike, por dikush tjetër do të donte të vlerësonte gjithashtu edhe rritjen e besimit të nxënësve, aftësinë e tyre për të diskutuar e debatuar për probleme të ndryshme, respektin dhe tolerancën e tyre për të tjerët dhe mendimin e të

tjerëve dhe aftësi të tjera të përgjithshme të tyre si marrëdhëniet ndërpersonale, të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve në situata të panjohura më parë.

OECD filloi t'i zhvillojë këto tregues "delikatë" në fillim të viteve 90 në përpjekje për t'u larguar nga vlerësimi standard i rezultateve akademike si e vetmja mënyrë për të gjykuar nivelin e një shkolle dhe për të futur gjithashtu edhe aspekte të tjera të rëndësishme të një edukimi të plotë. Tani më shumë se 20 vende marrin pjesë në botimin e treguesve cilesorë duke përfshirë edhe vlerësimin e dhënë nga publiku për tema të veçanta të kurrikulit, rëndësinë që i vihet cilësive dhe aftësive dhe shkallën e shpërqëndrimit të marrjes së vendimeve në shkollë.

Shpesh thuhet që kur dikush hyn në një shkollë të mirë, ai/ajo instiktivisht mund ta ndjejë nëse shkolla është mikpritëse, nëse nxënësit janë të interesuar dhe të zënë me punë dhe godina ka në përgjithësi një mjedis të përshtatshëm për qëllimin që ka shkolla. Shumë vende kanë zhvilluar gjithashtu një seri treguesish të tillë që të ndihmojnë në gjykimin e klimës së të mësuarit në shkollë. Ato mund të përdoren nga vlerësues të jashtëm dhe nga vetë trupat pedagogjike të shkollave. Kjo mënyrë mund të zgjerohet lehtësisht për të marrë informacione për zgjedhjen e kurrikulit, sjelljen dhe sigurinë e nxënësve dhe cilësinë e mjedisit, me fjalë të tjera, fushat delikate që janë kaq të rëndësishme në edukimin e plotë.

Problemi është se këta tregues delikatë dhe instrumentat e matjes së tyre akoma nuk janë në çantën e veglave të vetë shkollave (drejtorëve të tyre e mësuesve), të inspektorëve dhe të mbikqyrësve të shkollave apo zyrtarëve të Ministrisë. Shkollat përpiqen që t'i shqyrtojnë vetë proceset e ndryshimeve të tyre, por shpesh ato nuk kanë përvojën dhe aftësitë e mjaftueshme për këtë. Në përgjithësi është bërë një punë e pakët kërkimore për proceset që ndodhin në shkolla gjatë rrugës së ndryshimeve. Puna kërkimore "e zbatuar" nuk është popullarizuar në rajon dhe, bile në qoftë se ajo bëhet shkollat rrallë përfitojnë prej saj.

Për të kapërcyer këto pengesa dhe për të rritur nivelin e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm të veprimtarisë së shkollave nëpërmjet programit për vlerësimin e monitorimin në nivel shkolle synohet që për të parën herë të ndërtohet sistemi i treguesve bazë "sasiorë" e "cilesorë" nëpërmjet të cilëve të monitorohet e të vlerësohet puna në nivel shkolle. Kjo veprimtari do të sjellë nevojën që në të ardhmen të ndërtohen strukturat dhe logjistika e matjes së tyre nga vetë shkolla dhe nga vlerësues jashtë shkollës. Të gjitha këto do ta bëjnë më shkencor dhe të natyrshëm dialogun për përmirësimin e arsimit dhe do t'u japin në dorë atyre që marrin vendime në të gjitha nivelet argumenta të cilat janë rrjedhojë e analizës dhe debatit që zhvillohet duke patur në dorë tregues që mbulojnë gamën kryesore të problematikës së sistemit të arsimit në të gjitha nivelet.

Prej dhjetra vjetësh mblidhen të dhëna për funksionimin e sistemeve të arsimit, të dhëna që përbëjnë një instrument esencial për planifikimin dhe monitorimin e vetë sistemeve. Vetëm këto dy dhjetëvjeçarët e fundit informacioni dhe nevoja për të kanë njohur një rritje pa precedent. Sot ka gjithashtu një preokupim shumë të madh për cilësinë e

informacionit. Projekti PISA që po e bashkefinancojme së bashku me MASH është një prej këtyre përpjekjeve serioze

Në përgjithësi në sistemet arsimore të pakonsoliduara në fillim ka një rendje në rritjen e zhvillimit sasior të tyre. Kështu ka ndodhur edhe tek ne. Për ata që kanë qenë përgjegjës në marrjen e vendimeve pyetjet kryesore kanë qenë: Sa nxënës kanë qenë? Sa mund të thithim? etj. Edhe për sistemet si i yni, në disa nivele të arsimit si parashkollor dhe ai i mesëm këto pyetje mbeten përsëri evidente, bile në marrëdhëniet e tyre dhe me pyetje të tjera synojnë t'u japin në dorë atyre që marrin vendimet shpjegime nëpërmjet të cilave ato të jenë në gjendje që të përcaktojnë politikën e zhvillimit të këtyre niveleve të arsimit. Krahasimi i tyre edhe me tregues të njëjtë në vende të tjera, do t'i bënte vendimet që do të merreshin më objektive në përshtatje me kushtet e Shqipërisë dhe me zgjidhje që do të përmbanin gjetjet më efektive në përdorimin e rezervave financiare të mangëta. Për arsimin e detyruar pyetjet që lindin lidhen me mbajtjen dhe ruajtjen e niveleve të arritura, pasi në kushtet e sotme për arsye të ndryshme është rritur numuri i nxënësve që largohen nga shkolla dhe i atyre që e vijojnë atë me hope. Kështu kjo ka ardhur psh. si rezultat i pranisë së elementëve të rinj ekonomikë ende të pakonsoliduar si ai i krijimit në fshat i pronave të vogla private dhe përballjen e punëve bujqësore me krahun e lirë të punës, duke përfshirë këtu edhe fëmijët e moshës shkollore. Lëvizjet e vullshme demografike dhe rritja e shpejtë e popullatës shkollore ka krijuar në disa zona përqëndrime më të mëdha të kësaj popullate se sa janë mundësitë maksimale të godinave ekzistuese, pa folur për zona të reja urbane ku infrastruktura e arsimit mungon tërësisht. Ky fenomen i fundit lipset të shihet në kompleksitetin e vet me synime që të rregullohen shpërpjestimet që kanë lindur edhe në nivelet e arsimit.

Por pavarësisht nga këto sot gjithmonë e më shumë të gjitha pyetjet synojnë në: 'Çfarë cilësie arsimi mund të ofrohet? Në këtë mënyrë kërkohet të përcaktohen masat dhe format më të sofistikuara të vlerësimit të proceseve dhe të rezultatve të arsimit, si nga ana sasiore ashtu dhe nga ajo cilësore dhe mbi të gjitha për të stabilizuar krahasimet më të qëndrueshme dhe më serioze midis sistemeve të ndryshme të arsimit, sipas kërkesave të përgjegjësve politikë, të enteve publike dhe të përdoruesve.

Shumë faktorë kanë kontribuar për të përfocuar nevojën e një informacioni më të mirë dhe më të gjerë. Siç dihet në kushtet e sotme të vështirësive që ekzistojnë në rritjen e shpenzimeve publike, kërkesa për një cilësi më të mirë të arsimit do të bëhet e sforcuar pasi do të kërkonte përdorimin sa më të mirë të burimeve që disponohen. Në shumë vende përfshirja në procesin e përmirësimit të kësaj cilësie ka çuar në dhënien e një autonomie më të madhe shkollave, çka çon në atë që ato të bëhen të përgjegjshme për efikasitetin që duhet të tregojnë, edhe për këtë ato duhet të japin tani prova sa më objektive. Në fushën e ekonomisë konkurrenca është rritur mjaft dhe vendet e ndryshme shohin në sistemet respektive arsimore dhe të formimit profesional një mjet për të përmirësuar kompetitivitetin e sistemeve të tyre. Ata duan gjithashtu që të mund të krahasojnë sistemet e ndryshme për të ditur se ku mund të zbatojnë përmirësime.

Për t'u orientuar drejt një bote të përpunimit të politikave, që është në të njëjtën kohë më racionale dhe më e hapur, është e nevojshme që të kuptohen më mirë organizimi dhe

funksionimi i sistemeve shkollore në mënyrë që të dhënat që disponohen dhe analizat në të cilat ato të çojnë të jenë sa më të dobishme. Është e nevojshme që të përfshihen edhe metoda të reja të vlerësimit të cilat nga ana e tyre të lejojnë që të bëhen riparime në kuadrin e referimit mbi të cilin mbështetet debati mbi arsimin.

Një tregues arsimor shpreh diçka që lidhet me efikasitetin dhe sjelljen e një sistemi shkollor dhe mund të shërbejë gjithashtu për të trajnuar vendimmarrësit. Në përgjithësi statistikatat e arsimit nuk përmbajnë domosdoshmërisht të gjithë treguesit e mundshëm. Si të gjithë llojet e treguesve, pavarësisht nga fusha ku ato përdoren, konkretisht dhe treguesit arsimorë fokusohen në aspektet kryesore të objektit të tyre të studimit. Si rrjedhojë, pritjet që treguesit të japin përmbajtjen e gjendjes së sistemit në tërësi, të njëjës prej pjesëve të tij ose të një elementi. Natyrisht treguesit nuk thonë gjithshka për sistemet shkollore, por si dhe tregues të fushave të tjera, ato të japin një “profil të menjëhershëm” të situatës momentale.

Duke u nisur nga kompleksiteti dhe diversiteti i sistemeve arsimore është e natyreshme që një tregues i veçantë jep vetëm një informacion të kufizuar. Në mënyrë ideale një sistem treguesish jep informacione për menyrën se si komponentët e ndryshëm të sistemit arsimor funksionojnë në bashkëpunim për të prodhuar një efekt tërësor. Me fjalë të tjera vlera e kësaj pune është në kuptimin e marrjes së vendimeve ose të analizës së tërësisë së informacioneve të sjella nga një sistem treguesish. Për të patur një kuadër tërësor, treguesit e zgjedhur lipset të jenë si nga pikëpamja logjike dhe empirike të lidhur. Duke ndjekur këtë model, mund të përdoren kombinime treguesish për diagnozën e situatës aktuale dhe të ardhshme. Gjithashtu kombinime të veçanta treguesish mund të sjellin indikacione mbi çfarë është gabuar si dhe për ndryshimet që mund të çojnë në një përmirësim. Është punuar tani në një projekt që quhet “Të dhënat bazë në nivel shkollor” nëpërmjet të cilit do të informohet tërësisht rrjeti i të dhënave bazë në nivel shkollor dhe nëpërmjet programeve të caktuara kompjuterike do të bëhen kombinime treguesish, pasi vetëm kështu mund të nxirren përfundime për një problem të caktuar të sistemit arsimor.

Në zhvillimin e një sistemi ndërkombëtar të treguesve arsimorë zgjedhja e një modeli është tepër e vështirë për shkak të diferencave që ekzistojnë midis vendeve. (në parimet që drejtojnë politikën e tyre dhe të arsimit të tyre, si dhe në strukturën e institucioneve dhe në funksionimin e tyre). Është e nevojshme që të mos krijohen kundërshti në kontekstin kombëtar të sistemeve që krahasohen, në mpleksje me historinë, traditën, kulturën dhe vlerat që ndryshojnë si struktura dhe si sisteme. Por ekzistojnë dhe ngjashmëri fundamentale, midis vendeve më të industrializuara të botës, prandaj është e mundur gjetja e treguesve të përdorshëm e të pranueshëm nga të gjithë.

Ekzistojnë shumë forma të vlerësimit të arsimit, por karakteristika e tyre e përbashkët është ajo e vjeljes së informacioneve që mund të jenë sasiore ose cilësore, të rezervuara për përdorim administrativ ose për t’ia shpërndarë publikut. Në çdo rast informacioni është më shumë një ndihmë për të gjykuar, ndërsa metodat e analizës dhe mënyra e tyre e prezantimit mundet që në mënyrë domethënëse të rrisin ose të zvogëlojnë vlerën e përdorimit të këtij informacioni për vendimmarrje.

Në vendet anëtare të OECD-së përdorimi i treguesve për vlerësimin është shumë i përhapur nëpërmjet mekanizmave të kontrollit kombëtare ose rajonale, sondazhet e opinionit, anketave të inspektorëve dhe nëpërmjet mbledhjes së zakonshme të statistikave, etj. Prej disa vitesh nevoja e informacionit të këtij tipi është rritur si nga ana e politikanëve ashtu edhe nga ana e konsumatorëve.

Shumë tregues japin informacione përshkuese të çmuara të sistemeve arsimore që, shpesh rezultojnë shumë të vlefshme kur bëhet fjalë, psh.për të informuar publikun; por pjesa më e madhe e atyre që përdorin sistemet e treguesve është normalisht më e interesuar për krahasimet dhe për vlerësimin e cilësisë për t'iu përgjigjur pyetjeve për cilësinë se sa për anën sasiore të arsimit. Ka një rrezik që gjatë përdorimit të arrihen krahasime të lehta, gjë që mund të shkaktojë shqetësime për efikasitetin e përdorimit të treguesve. Pra lipset të synohet që nëpërmjet tyre të arrihen përfundime sa më të plota nëpërmjet shfrytëzimit sa më efektiv të mundësive që paraqesin ato.

Është e zakonshme që një studiues të ndërtojë një model të sistemit të arsimit që të kuptojë më mirë funksionimin e tij dhe të njëjtën gjë duhet të bëjë edhe për treguesit. Një shembull i vlefshëm, në këtë fushë është studimi i efektivitetit të shkollës. Shumë studime të zhvilluara në pjesë të ndryshme të shkollës i janë dedikuar analizës së faktorëve që duket se kontribuojnë në suksesin relativ të disa shkollave. Suksesi në përgjithësi matet në terma të rezultateve shkollore, por shpesh edhe në funksion të kriterëve shumë të ndryshëm në lidhje me shkollat e tjera. Kërkimet e drejtuara tani në këtë fushë lejojnë të bëhen interpretime më të sofistikuara për efikasitetin dhe për të kuptuar më mirë pse disa shkolla arrijnë rezultate të mira për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga origjina shoqërore ose etnike dhe nga seksi, ndërsa të tjera, në dukje në tërësi efikase, kanë rezultate më të ulëta për disa kategori nxënësish.

Përdorimi i treguesve në studimet krahasuese është i zakonshëm dhe në fushën e kërkimeve, por konsiderohet nga shumica thjesht si pikë nisjeje për analizën. Interpretimi i të dhënave sasiore pra i treguesve të tillë, mund të bëhet vetëm duke patur parasysh, vlerat, objektivat dhe strukturat e cilitdo sistemi edukativ: kështu, ato mund të behen të bëhet nga ekspertë kombëtarë, të cilët kanë një njohje e një kuptim të mirë të funksionimit të sistemit të tyre. Nga ana tjetër treguesit janë të ekspozuar ndaj interpretimeve të gabuara dhe potencialisht dhe ndaj një përdorimi jo korrekt. Kjo ndodh në mënyrë të veçantë kur kërkohet më tepër se sa duhet nga treguesit, kur këta, konsiderohen si mjete matjeje objektive dhe deri si instrumenta arbitrazhi se sa si masa të pjesshme, të paevitueshme dhe jo të besueshme në mënyrë të përsosur, të cilat më shumë se çdo gjë mund të jenë sinjalizuese, diagnostikuese dhe që të cekin problemet që kanë të bëjnë me përmirësimin.

Këto kufizime duhet që të njihen, në mënyrë të veçantë për të nënvizuar faktin që treguesit janë mbështetës të thjeshtë për gjykimet dhe nuk mund të zëvendësohen me momentet deçizive. Në fund të fundit, interpretimet se çfarë përfaqësojnë treguesit dhe vendimet politike që duhen adaptuar, do të influencohen më shumë nga informacionet objektive sesa nga gjykimi i vlerës (së treguesit). Por me ose pa tregues, përfundimet themelore në arsim nuk mund t'i shpëtojnë procesit politik, që do të thotë të refleksioneve

dhe të debatit midis vendimmarrësve dhe publikut që, në fund të fundit, është përgjegjës për funksionimin e mirë të shkollës.

Interpretimi i treguesve duhet të bëhet duke mbajtur parasysh kontekstin e objektivave dhe të vlerave të veçanta të çdo vendi: nuk duhet të lihen shifrat që të flasin “në vetvehte” (për hesap të tyre pa pasur parasysh kontekstin për të cilin bëhet fjalë).

Këto ishin vetëm disa refleksione për atë ç’ka po bëjmë për të përcaktuar e përdorur me efektivitet treguesit arsimorë. Diskutimi është tepër i gjerë dhe nuk mbyllet këtu. Dëshira është për të mirë. Ajo do të çojë në demokratizimin dhe decentralizimin e mëtejshëm të arsimit. Do të vijë dita që duke kaluar nga vleresimi në nivel shkolle, në nivel rrethi e pastaj në nivel kombëtar nëpërmjet analizës së treguesve do të arrihet të botojmë çdo vit për politikanët e publikun e gjerë një libër të bardhë me atë ç’ka arriti e problemet që kanë dalë në arsim në një vit shkollor. Kjo do të nxiste dialogun në përmasa të gjera e në mënyrë të arsyeshme. Në përgjithësi një dialog i tillë do të bënte që të ishim sa më realistë në nevojat për financime në arsim, për ndryshime në pjesë të caktuara të sistemit ose për ndryshime tërësore të tij.

Vasillaq Zoto
Senior Adviser

VLERESIMI I ARSIMIT NE SHQIPERI

Ceshtje te politikës se zhvillimit te vleresimit

Sistemi arsimor ne Shqiperi eshte ne nje proces reformimi te vazhdueshem, si ne forme ashtu dhe ne permbajtje.

1.Qe reforma te jete e sukseshme, mendojme, ajo duhet te marre ne konsiderate kerkesat e meposhtme:

- ◆ Te ruaje balancen dhe funksionimin e sistemit arsimor, pavaresisht nga natyra e ndryshimit dhe amplituda e tij;
- ◆ Politika arsimore te udhehiqet nga parime te qendrueshme, pavaresisht se cila force politike vjen e eshte ne fuqi;
- ◆ Te forcoje arritjet pozitive e qe i sherbejne zhvillimit te metejshem te reformes.

2. Sigurimi i cilesise se arsimit ne te gjitha nivelet, per te reflektuar ndryshimet e se tashmes e te perspektives te shoqerise shqiptare ne teresi. Kjo nenkupton:

- ◆ Nje shoqeri demokratike ka nevojte per individe me aftesi e shprehi te ndryshme;
- ◆ Ndryshimet ne kurrikula duhet te pasqyrohen edhe ne format e reja te vleresimit;
- ◆ Diversiteti social e ne shkollim kerkon monitorimin me te mire te standarteve arsimore;
- ◆ Mobiliteti social i individeve apo grupeve te caktuara sociale brenda e jashte vendit, imponon vendosjen e standarteve te matshme e te krahasueshme;
- ◆ Rritja e cilesise se instrumenteve te vleresimit per sigurimin e cilesise arsimore;
- ◆ Kryerja e vleresimeve kombetare e nderkombetare te nxenesve, per vleresimin edhe te inputeve te mesimdhenies e te nxenit, te tilla si : kurrikulumin, tekstet shkollore, mesuesit, infrastruktura shkollore.

Nese cilesia e inputeve arsimore ndikon ne cilesine e rezultateve arsimore, mund te theksojme se cilesia arsimore aktuale, eshte larg standarteve qe kerkon nje shoqeri moderne dhe e mbeshetur ne ekonomine e tregut.

Fusha e vlersimit arsimor eshte e gjere dhe komplekse. Ajo perfshin:

- ◆ Vlersimin e nxenesve, klasa 4,8,12 dhe provimet kombetare si dhe vleresimin e perditshem ne klase;
- ◆ Vleresimin e kurrikulumit, standartet lendore;
- ◆ Vleresimi i mesuesit, kompetencat e mesuesit, standartet, licencimi e certifikimi;
- ◆ Vleresimi i shkolles, akreditimi;
- ◆ Vleresimi i sistemit, treguesit e cilesise.

Potencialisht e gjithe shoqeria eshte e interesuar per njohjen e te dhenave te vlersimit te sistemit arsimor.

- ◆ Per rezultatet e nxenesve jane te interesuar ne rradhe te pare vete ata, prinderit e tyre, mesuesit qe u japin mesim e me pas mesuesit e tjere e drejtuesit e shkolles, punedhenesit e komuniteti i zones ku ndodhet shkolla. Ne nivel lokal, per rezultatet e nxenesve jane te interesuar organet arsimore lokale e per rezultatet e nxenesve ne shkalle vendi interesimi eshte akoma me i madh per hartuesit e politikave dhe vendimmarresit.
- ◆ Vleresimi i kurrikulave eshte objekt interesi jo vetem per mesuesit, por edhe per nxenesi, prinderit, hartuesve te politikave arsimore e vendimmarresve.
- ◆ Vleresimi i mesuesve eshte me mjaft interes e rendesi per drejtuesin e shkolles dhe organet lokale arsimore,por edhe per nxenesit , prinderit e tyre si dhe per organet perkatese qendrore.
- ◆ Vleresimi i funksionimit total te sistemit arsimor, angazhon drejtpersedrejti hartuesit e politikave dhe organet qendrore te arsimit si dhe perben objekt vemendjeje dhe veprimtarie te specializuar e te vazhdueshme te tyre.

Problemet e trajtuara me siper jane objekt i politikes se zhvillimit te vleresimit, ne vendin tone i cili ka karakteristikat e meposhtme dhe eshte pasqyruar ne projektin e Bankes Boterore "Reforma ne arsim":

- ◆ Njohja e nevojave dhe e situates ne nivel qendror, lokal, shkolle , insitucional, si dhe e publikut per ceshtje te vleresimit;
- ◆ Hartimi i nje dokumenti baze te politikes se zhvillimit te vleresimit;
- ◆ Krijimi i nje sistemi kombetar arsimor te vleresimit dhe provimeve;
- ◆ Informimi i publikut per ceshtje te vleresimit nepermjet buletineve e medias elektronike si dhe terheqja e mendimit te tij ne kete fushe.

Synimi kryesore i reformes arsimore eshte **sigurimi i cilesise se arsimit dhe per realizimin e tij, sherben krijimi i nje sistemi kombetar te vleresimit dhe provimeve.** Kryerja e reformimit te sistemit te vleresimit arsimor eshte nje proces i veshtire dhe per me teper me kosto, shpenzime te medha.Ky proces po realizohet me burime financiare te jashtme sic eshte kredia e Bankes Boterore akorduar shtetit shqiptar dhe per fushen e vleresimit arsimor, krahas komponenteve te tjere te arsimit.

A. Qendra Kombetare Arsimore e Vleresimit dhe Provimeve

Qendra Kombetare Arsimore e Vleresimit dhe e Provimeve e ka zanafillen qe ne vitin 1994, kur filloi te funksiononte nje berthame, si pjese e Institutit te Studimeve Pedagogjike.Qe nga ajo periudhe e deri sa u insitucionalizua si nje agjensi e shkeputur nga ISP dhe e varur nga Ministria e Arsimit dhe Shkences, me Vendim te Keshillit te Ministrave maj 2001, eshte synuar ne dy drejtime kryesore :

- ◆ Krijimi i kapaciteteve ne fushen e vleresimit, nepermjet trainimeve intensive te stafit te saj, brenda e jashte vendit ne insitucione prestigjioze e te mirenjohura ne fushen e vleresimit te tilla si UCLES,(Angli) CITO (Hollande), ETS (USA), NAES (Rumani) etj.
- ◆ Krijimi i nje infrastrukture teknike e te sofistikuuar per kryerjen e pergjegjesive e roleve te reja te Qendres.

Gjate kesaj periudhe statusi i Qendres Kombetare Arsimore te Vleresimit dhe Provimeve dhe i stafit te saj po ndryshon ne dy aspekte :

- ◆ Qendra eshte ne varesi administrative te Ministrise se Arsimit dhe Shkences;
- ◆ Stafi i Qendres gradualisht po ndryshon statusin e tij, pergjegjesite e rolet: nga specialiste lendore te pergatitjes se testeve, (gje qe e ka kryer deri tani per konkurset e pranimit ne Shkollat e Larta) ne eksperte per koordinimin dhe administrimin e vleresimeve dhe provimeve ne nivel kombetar.(pergjegjesite e reja te marra nga stafi i Qendres ne konkursin e pranimeve ne Shkollat e Larta , per kete vit, si dhe pilotimi i vleresimit te pare kombetar ne klasen e 4 filllore ne lendet matematike, gjuhe shqipe e lexim.)

Qendra Kombetare Arsimore e Vleresimit dhe Provimeve ka si qellim realizimin e sistemit kombetar te vleresimit dhe te provimeve.

Ajo vepron si nje njesi teknike , profesionale dhe mbeshtetese, per punonjesit e arsimit dhe ka per mision :

- ◆ Hartimin dhe administrimin e testeve si dhe instrumenteve te tjera te vleresimit te te nxenit;
- ◆ Perpunimin dhe kryerjen e analizave statistikore e psikometrike te te dhenave te siguruar nga testimet kombetare dhe nga provimet, me qellim permiresimin e tyre;
- ◆ Monitorimin e progresit te nxenesve ne ciklet kyce, informimin dhe dhenien e rekomandimeve perkatese Ministrise se Arsimit dhe Shkences;
- ◆ Mbledhjen e te dhenave sasiore dhe cilesore per zhvillimin e sistemit arsimor ne teresi dhe paraqitjen e te dhenave, rezultateve e te rekomandimeve perkatese, Ministrise se Arsimit dhe Shkences;
- ◆ Organizimin e programeve per pergatitjen e vleresuesve dhe personave te tjere te perfshire ne zhvillimin e provimeve e vleresimeve kombetare si dhe te vleresimit te perditshem ne klase

- ◆ Kualifikimin e mesuesve, te anetareve te rrjetit, si dhe te specialisteve te arsimit, per vleresimet e provimet kombetare si dhe te vleresimit te perditshem ne klase e progresit shkollor;
- ◆ Botimin e raporteve per rezultatet e e vleresimit dhe provimeve kombetare si dhe te materialeve te tjera te fushes se vleresimit arsimor;
- ◆ Zhvillon veprimtari kerkimore ne fushen e vleresimit arsimor;
- ◆ Hartimin e rregulloreve te organizimit dhe zhvillimit te provimeve kombetare, te cilat ia nenshtron aprovimit te Ministrit te Arsimit dhe Shkences.

Ne kete kuader Qendra do te ofroje ekspertize per :

- ◆ Vleresime te vazhdueshme ne arsimin parauniversitar ;
- ◆ Zhvillimin dhe zbatimin e formave te ndryshme te testimit dhe te procedurave te vleresimit si ne arsimin parauniversitar ashtu dhe ne ate universitar;
- ◆ Provimet kombetare e konkursin e pranimeve ne Shkollat e Larta, qe nga hartimi i pyetjeve e deri tek zbatimi dhe publikimi i rezultateve;
- ◆ Llogjistiken e hartimit te testeve, administrimin, publikimin e rezultateve, etj;
- ◆ Vleresimet kombetare ne ciklet e ndryshme arsimore;
- ◆ Vleresime te tjera ne ndihme te shkolles.

Aktivitetet kryesore te Qendres jane : provimet kombetare aktualisht te tilla si ato te klases 8, 12 dhe konkurset e pranimi ne Shkollat e Larta, dhe vleresimet kombetare ne ciklet kyc te shkollimit te nxenesve si ne klasen e 4, 8 dhe 12.

B. Provimet kombetare

Kuptimi per provimet.

Cili është qëllimi i provimeve?
Provimet mund të përdoren:

- ◆ Për të krahasuar arritjet e e një kandidati me të kandidatëve të tjerë që provohen për të njëjten temë ose lëndë.
 - ◆ Për të krahasuar përmbushjen nga ana e një kandidati të kriterëve specifike të arritjeve.
 - ◆ Nëpërmjet provimeve mund të kryhet matja e arritjeve relative dhe absolute.
 - ◆ Rezultatet e provimeve përdoren për të përcaktuar mundësitë e së ardhmes së një individi, për të kaluar në një cikël shkollor më të lartë
 - ◆ Për certifikimin e nxënësve, pas mbarimit të një kursi studimi .
 - ◆ Provimet reflektojnë qëllimet e sistemit arsimor, megjithëse është e vështirë të vlerësohet të gjitha qëllimet me të tilla provime.
 - ◆ Provimet shërbejnë për të zbuluar se sa mirë natyra dhe shtrirja e të mësuarit të nxënësve përputhet me qëllimet dhe objektivat e të mësuarit.
 - ◆ Të sigurojë një motivim ekstra për të mësuarin.
 - ◆ Për të marrë vendime të ndryshme pedagogjike për individin dhe mësimdhënien.
 - ◆ Për qëllime diagnostikuese.
 - ◆ Për të informuar të interesuarit për çështjet e arsimit rreth arritjeve arsimore.
 - ◆ Për të informuar mësuesit e tjerë të cilët kanë nevojë të marrin vendime për nxënësit e tyre.
 - ◆ Për të informuar prindërit rreth përparimit të fëmijëve të tyre në shkollë.
 - ◆ Për të mundësuar vlerësimin e efektshmërisë së mësimdhënies dhe të të nxënës.
 - ◆ Për të krahasuar arritjet e nxënësve të mësuar nga mësues të ndryshëm.
 - ◆ Për të vlerësuar mësuesit.
 - ◆ Për të siguruar informacion dhe për të krahasuar shkollat.
 - ◆ Për të siguruar informacion dhe për të vlerësuar arritjet e arsimit në nivel kombëtar.
- Qëllimet e mësipërme mund të përmbledhen në tre themelore:
- ◆ Certifikim;
 - ◆ Seleksionim;
 - ◆ Sigurim i informacionit rreth cilësive të arsimit.

Provimet mund të kryhen nga vete institucioni shkollor, (sistem provimi i brendshëm), nga jashtë sistemit arsimor (sistem provimi i jashtëm, që realizohet nga një agjensi e pavarur, siç është Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve., dhe nga institucioni shkollor në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit (sistem i perzjerë i provimit, që aktualisht realizohet në vendin tonë, provimi i klases 8 dhe i maturës).

Ndonese në vetevete provimi është vlerësim, ekzistojnë dallime midis vlerësimeve kombëtare dhe provimeve kombëtare. Më poshtë po japim këto dallime në mënyrë të përmbledhur :

C. PROVIMET	VLERESIMET KOMBETARE
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mund te merren nga te gjithë nxenesit ◆ Ne pergjithesi testi mbulon nje fushe te gjere te kurrikulumit ◆ Nuk merret informacion per variable te tjera, qe ndikojne ne arrijtet e nxenesve ◆ I njejti model i provimeve perseritet rregullisht, psh cdo vit. ◆ Publiku eshte mjaft i ndjeshem ndaj provimeve . Si rezultat shkallet (stakes) jane shume te larta si per agjensine qe eshte pergjegjese per hartimin e administrimin e provimeve ashtu dhe per politikanet. ◆ Nuk kerkojne teknika psikometrike per kalibrimin e testeve pas cdo provimi ◆ Per nxenesit, rezultatet e provimit jane te nje rendesie te madhe. ◆ Procesi i mesimdhënies dhe te nxënies mund te deformohet, meqe mesuesit dhe nxenesit perqendrohen tek mesimdhënia/nxëniti vetem per provim. ◆ Provimet mund te shfrytezohen per te influencuar ne praktiken e klases.(ky eshte nje efekt pozitiv) ◆ Ruajtja e sekretit te testit te provimit, eshte teper e larte. <p>Ne shume vende nxenesit paguajne tarifa te caktuara per provimet. (ne vendin tone nxenesit paguajne per konkursin e pranimeve ne Shkollat e Larta)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Shpesh, ato mbeshteten ne nje kampion perfaqesues te popullates qe do te testohet dhe nuk japin informacion per arrijtet e nxenesve te vecante. ◆ Testi vlereson objektivat me kryesore te kurrikulumit,thelbin e kompetencave te zoteruara nga nxenesit. ◆ Rezultatet e vleresimit analizohen ne lidhje te ngushte variable te tjera qe ndikojne ne arrijtet e nxenesve ◆ I njejti model i vleresimit nuk perseritet rregullisht per lende te ndryshme e per grup moshash te ndryshme. ◆ Kerkojne teknika psikometrike per kalibrimin e testeve pas cdo vleresimi, krahasimin midis tyre , etj ◆ Publiku nuk eshte shume i ndjeshem ndaj vleresimeve kombetare.Ato nuk paraqesin rrezik per politikanet dhe agjensine qe drejton dhe administron . ◆ Per nxenesit rezultatet e vleresimit kombetar nuk paraqesin ndonje rrezik. ◆ Procesi i mesimdhënies/nxëniti deformohet me pak,meqense ato nuk paraqesin ndonje rrezik. ◆ Nuk kane ndonje influence ne praktiken e klases(efekt negativ) ◆ Ruajtja e sekretit te testit nuk paraqet rrezikshmeri. ◆ Nxenesit nuk paguajne per pjesemarrje ne vleresimet kombetare.

Meqenese provimet luajne nje rol te rendesishem si per individin, prinderit dhe politikanet, pergjegjësia e institucioneve te specializuar sic eshte Qendra Kombetare Arsimore e Vleresimit dhe e Provimeve eshte shume e madhe dhe eshte objekt i gjykimit te te gjitha paleve te interesuar per to.Aktualisht Qendra jone eshte angazhuar ne konkursin e pranimeve ne Shkollat e Larta dhe ne vitet 2003, 2004, ajo do te hartoje e administroje teresisht provimet e klases 8 dhe 12.

Per here te pare Qendra per kete vit akademik shkollor, drejtoi konkursin e pranimeve ne Shkollat e Larta, sipas standarteve nderkombetare si ne aspektin e cilesise teknike ashtu dhe te monitorimit te te gjitha procedurave te zhvillimit te konkursit.Megjithate shume hapa mbeten per t'u arritur, si shkrimi i pyetjeve, pilotimi, krijimi i bankes se pyetjeve,ndertimi i testit, ceshtje te administrimit e korrigjimit.

Arrijte te sistemit te konkursit te pranimeve ne Shkollat e Larta

- ◆ Vendosja e sistemit te konkurrimit;
- ◆ Hartimi i testeve te standartizuara;
- ◆ Perpjekja per sigurimin e cilesise ne arsimin e larte;
- ◆ Kualifikimi i nje grupi specialistesh, pedagogesh, mesuesish per hartimin e administrimin e testimit;
- ◆ Mbeshtetja nga nxenesit, prinderit dhe shoqeria;
- ◆ Zvoglimi i dukurise se korrupsionit ne arsimin e larte;
- ◆ Dhenia per here te pare e disa kompetencave e pergjegjesive Qendres Kombetare Arsimore te Vleresimeve dhe Provimeve;
- ◆ Ngritja e grupit te jashtem te monitorimit te cilesise;
- ◆ Permiresimi i rregullores se konkurrimit;
- ◆ Permiresimi i skemes se korrigjimit, duke minimizuar dhe efektet negative te alternatives “E” : pa pergjigje .
- ◆ Botimi i materialeve udhezues per kandidatet konkurrues, per hartuesit e testeve dhe monitoret e cilesise.

Disa probleme e sfida per konkursin e pranimeve ne Shkollat e Larta

- ◆ Cilesia e pyetjeve vecanerisht e testeve te specialitetit eshte e pagarrantuar. Keto te fundit lidhen jo vetem me kohen kur realizohen e ne kushte jo normale, por edhe me teknikat e hartimit, shtypjes e paraqitjes se te tyre, te cilat jane te ndryshme nga nje fakultet ne tjetrin, nga nje universitet ne tjetrin.

Ne menyre ideale te gjitha pyetjet e testit duhet te merren nga banka e pyetjeve, baze e se ciles eshte para-testimi. Ne kete menyre njihen karakteristikat e pyetjeve. Megjithate mendojme se ekzistojne dy pengesa ne vendin tone per kryerjen e para - testimit :

- kosto e larte, shpenzime;
- ruajtja e sekretit.

Kjo e fundit eshte teper e veshtire qe te kapercehet. Nese para -testimi kryhet qofte edhe me nje numer te vogel nxenesish, eshte e veshtire te ruhet sekreti aq me teper ne kushtet e vendit tone ku lidhjet e ndermarredheniet midis njerzve jane prezente.

- ◆ Testi i pergjithshem dhe ai i specialitetit vleresojne te njejtat njohuri qe nxenesit i kane fituar ne shkollen e mesme, dmth, mbeshteten ne te njejtin kurrikulum.
- ◆ Mungesa e nje programi unik per korrigjimin e testeve;
- ◆ Mbingarkesa e kandidateve konkurrues. Brenda nje periudhe kohore 3 muajsh ata i nenshtrohen 2 lloje provimesh : te matures dhe te pranimit ne Shkollat e Larta.
- ◆ Mungesa e buletineve per rezultatet e pervitshme te konkursit te pranimeve ne Shkollat e Larta.

Duke u mbeshtetur ne problemet aktuale, e ne pervojen boterore, po paraqesim dy alternativa per reformimin e procedurave dhe te mekanizmave te perzgjedhjes se kandidateve per ne Arsimin e Larte.(Jane bere prezente para konferences se rektoreve ne bashkepunim me ZJ. Nikoleta Mita)

1 Kryerja e nje vleresimi kombetar

- ◆ Pergjegjes kryesor :

Qendra Kombetare Arsimore e Vleresimit dhe e Provimeve

◆ Mekanizmi kryesor :

Vleresimi kombetar i kandidateve ne 4 lende , te ndare sipas fushave kryesore

◆ **Avantazhet**

- Perqendrim i kompetencave e pergjegjesive ne nje organizem te vetem te specializuar
- Test i standartizuar
- Cilesi, besueshmeri dhe vlefshmeri me e larte
- Menjanim i korrupsionit
- Zbatim i modeleve nderkombetare

◆ **Disavantazhet**

- Shkollat e Larta nuk kane pervojen e perdorimit te mekanizmave te tjere perzgjedhes
- Nuk ekziston baza ligjore .

2. Nje test i vetem i arritjeve

◆ Bashkepergjegjes :

- Qendra Kombetare Arsimore e Vleresimit dhe Provimeve
- Shkollat e Larta

◆ **Mekanizmi kryesor**

- testi i arritjeve per programin e 8 lendeve te shkolles se mesme
- testi do te pergatitet nen drejtimin e Qendres Kombetare Arsimore te Vleresimit dhe Provimeve, nga grupet lendore te perbera nga perfaqesues te MASH, te universiteteve dhe te shkollave te mesme.
- Per deget qe kerkojne aftesi te vecanta do te perdoret testi i arritjeve dhe testi I aftesive me raportin 50 : 50.
- Administrimi dhe problemet e llogjistikes do te realizohen bashkerisht nga MASH, Qendra Kombetare Arsimore e Vleresimit dhe Provimeve dhe Shkollat e Larta.
- Testi i arritjeve per 4 fushat :

Shkenca sociale, shkenca humane, shkenca teknike, shkenca te natyres, perfshin 8 lendet e programit ekzistues ku numuri i pyetjeve te lendeve te fushave perkatese do te kete perparesi.

-Diferencimi i kandidateve me pike te njejta do te bazohet ne piket e lendeve qe jane paresore ne ate fushe.

◆ **Avantazhet**

- Ndarja e pergjegjesive
- Perdorimi i standarteve te njejta
- Shmangia e konfliktit midis testit te pergjithshem e atij te specialitetit
- Cilesi, besueshmeri e vlefshmeri me e larte
- Menjanim i korrupsionit
- Shanse per kandidatet qe kane rezultate te mira ne lendet e fushes ku konkurrojne

◆ **Disavantazhe**

- Mbingarkese e kandidateve.

Vleresimi i efektivitetit te provimeve

Per nje agjensi e specializuar ne fushen e vleresimit, eshte me rendesi kryerja e vleresimit te efektivitetit te provimeve qe ajo administron.Zakonisht kjo merr formen e analizes

sasiore e cilesore te pyetjeve dhe te realizimit te testit. Cdo vleresim i provimeve perfshin:

- ◆ Shperndarjen e pikeve te testit dhe statistika pershkruese;
- ◆ Vleresimin e besueshmerise se testit;
- ◆ Korrelacionin midis komponenteve te provimit;
- ◆ Vleresimin e nivelit te veshtiresise se pyetjeve dhe te diskriminimit;
- ◆ Vleresimin e vlefshmerise se testit

Qendra Kombetare Arsimore e Vleresimit dhe Provimeve, per here te pare do te kryeje nje studim te gjere per testimin qe u krye per konkursin e pranimeve ne Shkollat e Larta , shtator 2001. Kryerja e ketij studimi do t'i sherbeje:

- monitorimit te arritjeve te kandidateve konkurrues;
- krijimit te bankes se te dhenave per nivelin e arritjeve te nxenesve te shkolles se mesme;
- permiresimit te pyetjeve te testit per konkursin e ardhshem per pranimet ne Shkollat e Larta
- evidentimit te problemeve te kurrikulave te shkolles se mesme;
- evidentimit te nivelit te shkollave te mesme,
- botimit te rezultateve te konkursit, per informimin e publikut, nxenesve, mesuesve e prinderve si dhe hartuesve te politikave dhe vendimmarresve;
- reformimit te procedurave te zhvillimit te konkursit per pranimet ne Shkollat e Larta.

Pavaresisht se cfare vendimi do te merret nga organet pergjegjese per konkursin e pranimeve ne Shkollat e Larta, shume probleme kerkojne vendime politike ne nivel te larte te tilla si menyra e shperndarjes se testeve ne universitete, rritja e besueshmerise se korrigjuesve te testeve, vendosja e konsensusit midis universitetve, Qendres se Vleresimit e MASH, sekretimi i testeve etj.

Vleresimet kombetare

Qellimet e vleresimit kombetar

Ne literature zakonisht permenden 4 qellime te vleresimit kombetar :

- ◆ Rritja e vlefshmerise te objektive te sistemit, dmth, monitorimi i arritjeve te nxenesve per boten e punes;
- ◆ Rritja e efektivitetit te sistemit, dmth, sa sistemi eshte konkurues per individet e si ndikon per zhvillimin e tyre;
- ◆ Rritja e eficiencies te sistemit, dmth , rritja e cilesise ne kushtet kur disa variable ndryshojne e disa jo, psh, rritja e numurit te nxenesve te rregjistruar ne shkolla, nuk shoqerohet me rritje te fondit.
- ◆ Dhenia llogari ne nje sistem te decentralizuar, dmth, nje autonomi me e madhe per autoritetet lokale kerkon nga qeveria qendrore te jap llogari per rezultatet e arsimit. Vleresimi kombetar mund te zbuloj efektivitetin dhe eficiencen e pjeseve te sistemit si te shkolles, organeve lokale si dhe metodat per te permiresuar rezultatet e tyre.

Vleresimi kombetar dhe politika kombetare arsimore

Nje nga synimet e vleresimit kombetar eshte te informoje vendimmarresit cili eshte niveli i arsimit. Te dhenat e vleresimit kombetar i ndihmojne hartuesit e politikave dhe vendimmarresit per te diagnostikuar problemet, per formulimin e reformes dhe per te permiresuar eficiencen.

Instrumentet e perdorura ne vleresimin kombetar bazohen ne standartet , te cilet tregojne se cilat jane qellimet e arsimit.Por ne vleresimin kombetar perdoren dhe instrumente te tjera , per te matur variable te tjera qe ndikojne ne arritjet e nxenesve.

Bazuar ne te dhenat e vleresimit kombetar, hartuesit e politikave percaktojne aspektet e zhvillimit te sistemit arsimor, duke vene thekse njerit apo tjetrit aspekt. Prandaj, hartuesit e politikave, vendimmarresit, dhe te gjitha te interesuarit ne fushen e vleresimit duhet te mbeshtetin e perkrahin kryerjen e vleresimeve kombetare.

Por nga ana tjetere, instrumentet e vleresimit duhet te ndertohen e administrohen ne mneyre te tille qe rezultatet te kene perdorim te shumanshem dhe te krahasueshme ne kohe.

Vleresimi kombetar dhe standartet

Standartet dhe vendosja e standarteve eshte nje ceshtje e rendesishme ne vleresimin kombetar.Instrumentet e vleresimit dhe rezultatet e vleresimit duhet te mbeshteten ne standartet, sepse ato percaktojne dhe qartesojne kurrikulumin zyrtar , duke na dhene nje pamje realiste per nivelet e arritjes se nxenesve.Pergjigja per pyetjen “sa e mire eshte e mira e mjaftueshme” ka shume dimensione, nje nga te cilat jane edhe standartet.

Ndersona procedurat e vendosjes se standarteve ne vetvete eshte nje ceshtje teper e komplikuar. Nje nga detyrat e Qendres se vleresimit eshte qe nepermjet Vleresimit te pare kombetar ne klasen e 4 fillore , te vendosen edhe standartet.Ajo duhet te perdore teknika te ndryshme e te avancuara statistikore me qellim per te siguruar standarte te arritjes te vlefshme e te perdorshme.

Roli i vleresimit kombetar

Per te kuptuar se cfare lloji vleresimi kombetar duhet te kryhet ne nje vend, eshte e rendesishme te njihen rolet e vleresimit.

- ◆ Informon hartuesit e politikave :
 - Vleresimet kombetare sigurojne informacion, psh per diferencat ne arritjen e shkollave te lidhura me vendndodhjen gjeografike, perkatesine gjinore, etnicitetin etj.
 - Nepermjet te dhenave nga vleresimet kombetare kontrollohet permbajtja e kurrikulimit, pikat e forta e te dobta te fushave te tij si dhe metodat e mesimdhenies.
- ◆ Monitorimi i standarteve .Vleresimi kombetar siguron te dhena per situaten e standarteve arsimore ne kohe.
- ◆ Identifikimi i variableve te tjere qe ndikojne ne arritjet arsimore te nxenesve, te tilla si kualifikimit te mesuesve, tekstet, infrastruktura shkollore, etj.
- ◆ Nxit pergegjesine per dhene llogari.
 - Qeveria behet me e pergjegjshme per vlerat e arsimit dhe parate e investuara per te.

- Autoritetet lokale dhe shkollat mund të jenë më të përgjegjshme për rezultatet e tyre.
- Prinderit mund t'i përdorin rezultatet për të zgjedhur shkollat;
- Mesuesit mund të vlerësohen apo të kritikohen sipas rezultateve të vlerësimit kombëtar.
- ◆ Ndergjegjësimi i publikut dhe informimi. Informacioni për rezultatet e vlerësimit ndergjegjëson publikun për çështje të arsimit e të reformës.

Informacioni për vlerësimin kombëtar është i rëndësishëm dhe i shërbën qëllimeve të kryerjes së tij, vetëm nëse është i qartë, i pakomprometuar dhe i besueshëm .

Avantazhet e vlerësimit kombëtar

- ◆ Vlerësojnë në nivele të veçanta , lende dhe objektiva;
- ◆ Identifikojnë faktorë që ndikojnë pozitivisht ose negativisht në arritjet e nxënësve;
- ◆ Kërkojnë relativisht kosto jo shumë të larta, nëse vlerësimi bëhet mbi baze kampioni;
- ◆ Ato nuk e deformojnë procesin e mesimdhënies.

Disavantazhet e vlerësimit kombëtar

- ◆ Kane një backwash të kufizuar sepse janë aktivitete që nxënësit, mesuesit etj nuk rrezikojnë shumë;
- ◆ Kërkojnë aftësi të veçanta dhe ekspertizë;
- ◆ Mund të abuzohet me informacionin që ato sigurojnë.

Pilotimi i vlerësimit të parë kombëtar në klasën e 4 filllore në lëndet matematike, gjuhë shqipe e lexim.

Vlerësimi i parë kombëtar në klasën e 4 filllore në lëndet matematike, gjuhë shqipe e lexim do të kryhet në maj të 2002. Faza e parë e tij është pilotimi i cili u krye në maj të 2001.

Qëllimi : Evidentimi i vështirësive së pyetjeve, çështje të administrimit, llogjistikes, etj.

- U krye në maj 2001
- U përfshinë nxënësit e klasës së 4 filllore
- Lëndet e vlerësuara : Gjuhë shqipe, lexim, matematike
- Kampioni : 1050 nxënës, 29 shkolla me shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e vendit
- Përgjegjësi : Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe e Provimeve
- Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe e Provimeve vendosi :
- Politiken e vlerësimit të parë kombëtar
- Programin e kurrikulumit e të vlerësimit
- Instrumentet e vlerësimit

- Ndertimin e testeve, numrin e tyre, organizimin e tyre, skemen e korrigjimit
- Manuallet e administratorit te testeve, te monitorit te cilesise, te koordinatorit te shkolles e te koordinatorit rajonal
- Treinimi i korrigjuesve
- Eshte pergatitur raporti

Ne te ardhmen Qendra do te perballohet me detyra e pergjegjesi te shumta dhe sfida per reformimin e metejshem e zhvillimin e sistemit te vleresimit. Te gjitha aktivitetet e saj kerkojne :

- burime njerezore,
- fizike,
- financiare,
- profesionalizem
- konsensus
- zbatim
- cilesi

Ndryshimi kerkon kosto, eshte i veshtire dhe i ngadalshem. Ndryshimi ndodh kur njerezit e pranojne ate, dhe jane te gatshem per te riskuar.

Dr. SHPRESA PETRELA
Drejtore, Qendra Kombetare Vleresimit

Treguesit e arsimit parashkollor

Prof. Asoc. Dr Erlehta Mato
Drejtuuese e Departamentit të Edukimit në QSHDNJ

Monitorimi i progresit dhe i eksperimenteve në një sistem edukimi varet kryesisht nga indikatorët të cilët aftësojnë autoritetet qeverisëse të një vendi dhe grupet e tjera të interesuara për të gjykuar kontaktin dhe funksionimin e arsimit, si dhe rezultatet e arritura. Kështu, indikatorët e edukimit të fëmijërisë së hershme na nxjerrin në pah disa nga dobësitë më kritike të edukimit parashkollor dhe na ndihmojnë për të hartuar politika korrigjuese, nqse sigurisht politikanët dhe shoqëria jonë duan t'i ndryshojnë gjërat për mirë.

Për lehtësi referimi, do të doja të ndalesha në disa nga indikatorët bazë të arsimit parashkollor, duke mos i quajtur të parëndësishëm dhe të tjerët që për arësye të kohës që kam në dispozicion nuk do t'i prek apo do t'i anashkaloj.


Arsimi parashkollor përbën hallkën e parë të sistemit tonë arsimor. Aktualisht kjo hallkë përfaqësohet nga sistemi i unifikuar i cerdheve dhe i kopshteve publike ku tëhiqen fëmijët nga mosha 1 – 5 vjec (cerdhet 1-3 vjec dhe kopshtet 3 – 5 vjec), por dhe nga sistemi i parashkollorit privat i cili edhe pse është në hapat e para ka një tendencë zhvillimi të shpejtë.

D. Aksesit, pjesëmarrja dhe progresi

1. Regjistrimi dhe frekuentimi i fëmijëve në kopshte

Përqindja e lartë e 3 – 6 vjecarëve të regjistruar në kopsht në shumicën e vendeve të Evropës që shkon deri në masën 100 % në Francë, rreth 90 % në Angli, Hollandë, Belgjikë etj na bën të reflektojmë për rëndësinë që ka pjesëmarrja e fëmijëve në edukimin parashkollor dhe vlefshmërinë e programeve të përshtatshme për zhvillimin e plotë të parashkollorit. Të gjithë fëmijët duhet të kenë mundësi edukimi jo vetëm në kopshtet ekzistuese, por dhe duke krijuar alternativa që ndihmojnë ata dhe familjet e tyre për më shumë sukses në zhvillim.

Pjesëmarrja e fëmijëve në edukimin parashkollor në vendin tonë, në vitin 2001 paraqitet më e ulët krahasuar në vitin 1990. Sot tërhiqen 23 % më pak e fëmijëve 3-5 vjecarë, gjë që do të thotë se rreth 65 % e fëmijëve të kësaj moshe janë të përjashtuar nga edukimi I institucionalizuar. Dinamika e rënies së numrit të fëmijëve në kopshte paraqitet në grafikun e mëposhtëm.



Arësyet kryesore të uljes së numrit të fëmijëve që ndjekin kopshtet janë:

- kapacitetet e pamjaftueshme të lokaleve (zënia forcërisht e kopshteve dhe përdorimi i tyre si godina banimi, tjetërsimi i destinacionit të kopshteve nga organet e pushtetit lokal, kthimi i godinave të përshtatura për kopshte pronarëve, investime shumë të pakta të shtetit për kopshte të reja gjatë këtyre viteve etj)
- përqindja e lartë e papunësisë në radhët e grave që tashmë janë brenda mureve të shtëpisë dhe merren me kujdesin ndaj fëmijës
- niveli i lartë i varfërisë, sidomos në zonat rurale por dhe ato urbane që nuk u lejon familjeve të paguajnë për edukimin e fëmijëve të tyre në institucionet parashkollore

Vitin e fundit shihet një tendencë pozitive e familjeve në zonat urbane për të siguruar edukimin e fëmijëve në kopshte, edhe kur nënat nuk janë të angazhuara në punë.

E. Kurrikula dhe arritjet

Programet e ofruara nga kopshtet shërbejnë që publikut të sotëm t'i jepet një larmi alternativash edukimi të mbështetura në nevojat e fëmijës dhe të vetë familjes. Përmbajtja e kurrikulës dhe qëllimet e aktiviteteve të ndryshme brenda dhe jashtë kopshtit luajnë një rol të rëndësishëm në përhapjen ose jo të kërkesës për institucionet e edukimit të fëmijëve parashkollore.

Gjatë viteve '93 - 2001, edhe pse treguesit e pjesëmarrjes së fëmijëve në kopshte kanë ardhur duke u ulur, është punuar me rezultate të kënaqshme në përmirësimin e kurrikulës së parashkollorit dhe vendosjes së standardeve bashkëkohore në edukimin e tyre. Kështu, ndryshe nga nivelet e tjera të shkollimit të cilat paraqiten mjaft konservatore përballë ndryshimit, kopshtet publike në përgjithësi, kanë qenë qendra të përfshirjes së elementëve të përparuar të modeleve të tilla si "Hap pas hapi", "Rexhio Emilia", "Montesori" etj. Përshtatja e modeleve të mësipërme në sistemin tonë parashkollor e ka pasuruar mjaft këtë të fundit duke bërë që tashmë të kemi aftësi dhe qëndrime të reja përkundrejt integritit lëndor dhe metodologjive bashkëkohore, përfshirjes së prindërve në klasë dhe jashtë saj, pedagogjisë së edukimit të fëmijëve parashkollore etj.

F. Organizimi dhe manaxhimi i institucioneve parashkollore

Organizimi dhe manaxhimi i institucioneve parashkollore përbëjnë një drejtim të rëndësishëm të vendosjes së indikatorëve cilësorë në punën e mësuesve dhe arritjet e fëmijëve. Le të shohim disa prej këtyre treguesve

1. Masa e fëmijëve në grup dhe raporti mësues - fëmijë

Tashmë dihet që klasat me masa të vogla vlerësohen sepse ato lejojnë fëmijët që të fitojnë më shumë vëmendje dhe afeksion nga mësuesit e tyre, gjë mjaft e rëndësishme për këtë moshë dhe nga ana tjetër reduktojnë stresin e mësuesve për të manaxhuar grup të madh fëmijësh në punën e tyre ditore.

Edhe pse ekziston një standard tashmë i përcaktuar dhe jo larg atij evropian për një klasë ku numri i fëmijëve nuk duhet të kalojë 25 -30, sot kemi një tablo disproporcionesh të cilat shfaqen vecanërisht në qytet ku ekzistojnë edhe klasa me 45 – 50 fëmijë, po ashtu sikurse ka dhe raste që në zonat e thella ky numër i fëmijëve për klasë ulet deri në më pak se 15.

Po kështu dhe raporti mësues fëmijë nuk i përgjigjet filozofive të reja të edukimit që kërkojnë mësim të individualizuar ose punë në grupe të vogla, pasi ky raport sic u shprehëm më lart shpesh është i pabalancuar dhe dëmton arritjet e fëmijëve.

Kopshtet private shfaqin një tendencë më pozitive në masën e përshtatshme të grupit dhe në përmirësimin e raportit mësues fëmijë nga 1 me 20 apo 25 në 1 me 15.

2. Formimi dhe zhvillimi profesional i mësuesve

Mësueset e arsimit parashkollor deri në vitin 1994 përgatiteshin në shkollat e mesme pedagogjike, dega edukatore. Pas këtij viti, me hapjen e degës së mësuesisë për arsimin parashkollor pranë universiteteve në rrethe, ato përgatiten me arsim të lartë. Aktualisht 68% e tyre figurojnë me arsim të mesëm pedagogjik, rreth 11 % me arsim të lartë dhe 21 % me arsim të mesëm joprofesional.


Në mënyrë që formimi dhe zhvillimi profesional i mësuesve të jetë i vazhdueshëm shumë vende kanë struktura të vecanta që ofrojnë seminare trajnimi të cilat synojnë dhënien e njohurive të reja dhe praktika të mësuarit që ngrenë nivelin cilësor të punës që bëhet në kopsht. Në vitin 2001, një strukturë e tillë mungon, gjë që jep dy pamje të ndryshme të zhvillimit të stafit të mësuesve; nga njera anë mësueset e zonave urbane ku funksionojnë agjensi të ndryshme që ndihmojnë ato në zhvillimin profesional, nga ana tjetër mësueset e zonave rurale që kanë vite që nuk kanë marrë pjesë në asnjë seminar trajnimi.

Edhe në kopshtet private zhvillimi profesional i stafit nuk konsiderohet si prioritet dhe gjendja ekzistuese tregon se shpesh në këtë drejtim aty punohet më pak se në kopshtet publike.

Përsa i përket materialeve të tjera ndihmëse për zhvillimin e tyre profesional ka më shumë se 10 vjet që nga shteti nuk ndërmerret asnjë nismë e ngjashme me atë që zhvillohet cdo shtator për arsimin e detyruar. (pra për botime në ndihmë të mësuesve të arsimit parashkollor)

3. Personeli mësimor dhe jomësimor

Personeli i kopshtit përbëhet nga mësues dhe nga personeli ndihmës i shërbimit. Pas vitit '94, në përputhje me filozofinë e re të edukimit që u fut në institucionet tona parashkollore dhe konkretisht në dy nga modelet më të sukseshme si “Hap pas hapi” dhe “Rexhio Emila” u përvijuan dhe figura të reja, të ndryshme nga ato tradicionalet: kordinatorja familjare dhe atelieristja. Natyrisht numri i tyre është i kufizuar dhe i përqëndruar vetëm në modelet që përmendëm, për shkak të kushteve ekonomike. Sot në kopshtet tona ka 4092 mësuese ose 1572 më pak se në vitin 1990. Grafiku i mëposhtëm paraqet vlerat gjithnjë në ulje të këtij treguesi.



G. Burimet njerëzore dhe financiare

Ndryshe nga shumë vende të tjera, në Shqipëri nuk ekziston një shifër e saktë e shpenzimeve të edukimit për fëmijën parashkollor. Sidoqoftë më poshtë do të përiqemi të ndalemi në disa tregues të tjerë të cilët do të na qartësojnë investimet e bëra nga shteti dhe nga burime të tjera në këtë nivel edukimi.

1. Kapacitetet lokale


Sipas statistikave të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, në vitin 1994, 28% e të gjitha godinave të kopshteve kanë qenë objekte të ndërtuara për këtë qëllim, ndërsa 72% e kopshteve kanë funksionuar në godina të përshtatura.

Në këtë vështrim institucionet tona parashkollore janë larg mesatares së normave ndërtimore bashkëkohore, gjë që ndikon si në shëndetin e fëmijëve, ashtu dhe në realizimin cilësor të kurrikulës.

Përveç mungesës së shumë elementëve si oborreve, sistemeve qendrorë të ngrohjes etj ajo që vlen të theksojmë është se ndërsa mesatarja evropiane arrin 3 m katror për fëmijë, në kopshtet tona mesatarja e normës së sipërfaqes së klasës për fëmijë është 1.8 m katror.

Sot një nga problemet më të mprehta që lidhet me numrin e ulët të fëmijëve që ndjekin kopshtin në zonat urbane është mungesa e lokaleve të kopshteve. Investimet e shtetit në këtë nivel shkollimi janë mjaft të ulta, dhe ashtu sikurse dhe donatorëve të tjerë ato janë të përqendruara më shumë në rikonstruksione të godinave ekzistuese se sa në ndërtimin e lokaleve të reja.

Më poshtë, paraqitet gjendja e lokaleve të kopshteve në vite:



Sipas kësaj paqyre, në vitin '99 në zonat urbane kemi patur 422 kopshte më pak se në vitin 1990 dhe në zonat rurale 674 më pak. Gjendja gradualisht po përmirësohet në zonat urbane me zhvillimet e arsimit privat

2. Rrogat e mësuesve

Treguesit në këtë aspekt janë mjaft të ulët. Rrogat në arsimin parashkollor nuk motivojnë mësuesit e këtij cikli, sidomos të atyre që përfundojnë arsimin e lartë në këtë degë për të punuar në kopshte. Një pjesë e madhe e tyre parapëlqejnë punë të tjera, duke bërë që në këtë nivel shkollimi të punojë kuadër jo i përshtatshëm.

Këto ishin disa nga indikatorët e arsimit parashkollor në vendin tonë. Ato folën me gjuhën e tyre duke treguar se shanset në letër janë për të gjithë fëmijët, por realiteti nuk u mundëson të gjithëve atë që letrat thonë. Duhet më shumë kopshte, më shumë libra dhe kompjutera, mësues më të mirë dhe politikanë akoma më të mirë që të kujtojnë në cdo moment se fëmijët janë dielli dhe stuhia e të nesërmes. Le të mblidhemi më shpesh për të marrë vendime në favor të tyre.

Tabela: Të dhëna bazë për zhvillimin e arsimit parashkollor në dekadën e fundit

Vitet	1990/91	1991/92	1992/93	1993/94	1994/95	1995/96	1996/97	1997/98	1998/99
-------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	---------

Numri i kopshteve									
Gjithsej	3426	3174	2784	2656	2668	2670	2656	2408	2330
Qytet	804	793	676	362	334	333	338	328	382
Fshat	2622	2381	2108	2294	2334	2337	2318	2080	1948
me ushqim gjithsej	665	384	221	111	90	93	100	100	97
Qytet	314	315	212	108	90	93	100	100	97
Fshat	351	69	9	3	0	0	0	0	0
Numri i fëmijëve në kopshte									
Gjithsej	130000	108880	81117	80395	80384	84536	84232	80418	81734
qytet	61185	54564	38055	32274	32650	34495	35389	33741	37013
fshat	68815	54316	43062	48121	47734	50041	48843	46677	44721
me ushqim gjithsej	31820	23823	9047	4290	5448	6846	8726	8370	9173
qytet	26478	22735	8885	4290	5448	6846	8726	8370	9173
fshat	5342	1088	162	0	0	0	0	0	0
Numri dhe niveli arsimor i edukatoreve									
Gjithsej	5664	5440	5081	4578	4428	4416	4463	4116	4092
qytet	2771	2787	2407	1789	1691	1697	1732	1704	1779
fshat	2893	2653	2674	2789	2737	2719	2731	2412	2313
Me ars. të mesëm									
gjithsej	5385	5184	4771	4359	4228	4151	4120	3816	3678
qytet	2516	2546	2130	1589	1520	1491	1488	1470	1480
fshat	2869	2638	2641	2770	2708	2660	2632	2346	2198
Me arsim të larte									
gjithsej	279	276	303	225	200	265	343	300	414
qytet	255	257	269	206	171	206	244	234	299
fshat	24	19	34	19	29	59	99	66	115
Raporti fëmijë/edukatore									
gjithsej	23	20	16	18	18	19	19	20	20
qytet	22	20	16	18	19	20	20	20	21
fshat	24	20	16	17	17	18	18	19	19

Indikator	Vlera
Regjistrimi i fëmijëve	35 %
Raporti mësues - fëmijë	21:1
Nr mesatar për klasë	23

“Integrimit i Indikatorëve Shqiptarë të Arsimit me Indikatorët e OECD për arsimin.”

Besa Peçi, MASH

Qëllimi i projektit

“Vendosja dhe përmirësimi Step by Step i një sistemi të qëndrueshëm për mbledhjen, llogaritjen, shpërndarjen dhe krahasimin e statistikave dhe treguesve në arsim, si një mjet orientues në hartimin e politikave arsimore shtetërore nëpërmjet bashkërendimit me treguesit e OECD”.

Nga shtatori i vitit 2000 shtator 2001 grupi i punës i përbërë nga përfaqësues të AEDP, MASH, INSTAT, MIN.FINANCAVE i financuar nga AEDP punoi për projektin “Integrimit i treguesve shqiptarë të arsimit me treguesit e OECD për arsimin.”

Grupi i punës ka punuar nën drejtimin e specialistes së statistikës **Besa Peci** dhe kujdesin z. **Vladimir Pasku** nga AEDP:

Grupi i Punës

1.Garufa Noti	Min.Financave
2.Lili Dode	INSTAT
3.Eleni Çoka	Min.Ars.Shkenës
4.Merita Haxhiu	Min.Ars.Shkenës
5.Illir Kokomiri	Drejtoria Arsimore
6.Agim Gorana	Drejtoria Arsimore

Etapa e I-rë

- Në këtë etapë puna filloi me njohjen e **“Paketës së treguesve në arsim”** material i përgatitur më parë nga AEDP. “Paketa e treguesve në arsim” shpjegon në mënyrë të hollësishme teorikisht llojet dhe rëndësinë e treguesve të arsimit në tre nivele; kombëtar, lokal, institucional.
- **Pas kësaj njohje teorike** puna vazhdoi me studimin analitik të botimit të OECD **“EDUCATION AT A GLANCE OECD Indicators”** duke studiuar tabelat me të dhëna si dhe paraqitjen grafike të tyre në të cilën paraqitet situata për çdo tregues të vendeve pjesëmarrëse në OECD.
- Po kështu u studiuan edhe shpjegimet të ndryshme në lidhje me këta indikatorë
- Pra në përfundim të kësaj etape të studimit teorik dhe praktik të indikatorëve të prodhuar nga OECD i gjithë grupi i punës ishte njohur me përmbajtjen dhe rolin e këtyre treguesve.

Etapa e II-të

- **Më pas u studiuan dhe u analizuan baza e të të dhënave** që disponojnë institucionet tona dhe **treguesit egzistues të llogaritur** nga **MASH, INSTAT, MIN.FIN** të cilët shërbejnë si informacion bazë për realizimin e këtij qëllimi.
- Një moment tepër i rëndësishëm i sigurimit të të dhënave që janë baza e llogaritjes së indikatorëve është sigurimi i të dhënave të popullsisë.
- Tepër me vlerë nga informacioni i rregjistrimit të popullsisë paraqiten të dhënat e popullsisë me grup moshë dhe nivel arsimor e punësimi që do të sigurohen nga **“Regjistrimi i Popullsisë 2001”**.

Etapa e III-të

Grupi i punës konkludoi që **janë të nevojshme edhe disa të dhëna** që nuk janë prodhuar deri tani.

Kështu nuk disponoheshin të plotë nga **Ministria e Arsimit & Shkencës**:

- Numri i mësuesve sipas niveleve dhe grupmoshave
- Të dhëna për arsimin privat
- Numri i diplomantëve sipas grup-moshave.

Në këto momente që diskutojmë mënyra e mbledhjes së këtij informacioni shtesë është siguruar.

Po kështu në faza të mëvonshme të vazhdimit të projektit do të kalohet pjesë pjesë në përcaktimin e të gjithë informacionit bazë që duhet për integrimin e plotë të statistikës shqiptare në ato ndërkombëtar.

Etapa e IV

-Më pas u kalua në përcaktimin dhe ndërtimin e tabelave bazë që nevojiten me të dhëna nga të tre institucione Instat, Ministria Financave, Ministria Arsimit për të siguruar informacionin bazë si më poshtë:

Instat

1. Popullsia
2. Popullsia sipas grup-moshave dhe nivelit arsimor
3. Të punësuarit sipas sektorëve
4. Të punësuarit në sektorin shtetëror sipas nivelit arsimor
5. Të papunë të rregjistruar sipas gjinisë dhe grupmoshave
6. Të papunë të rregjistruar për vitin ____
7. Paga mesatare mujore në arsim

Ministria e Financave

1. Shpenzimet publike për arsimin sipas niveleve arsimore dhe zërave nga burime të brendshme
2. Shpezimet publike për arsimin (parauniversitar+universitar) sipas zërave nga burime të brendshme
3. Burimet e financimit
3. Investimet e sektorit të arsimit në vite.

Ministria e Arsimit & Shkencës

Të gjitha tabelat e tjera që kanë të bëjnë me:

1. Numri i nxënësve të regjistruar në të gjitha nivelet arsimore dhe nxënës të regjistruar sipas specialiteteve
2. Numri i mësuesve në të gjitha nivelet arsimore
3. Numri i institucioneve shkollore
4. Grup moshat e popullatës shkollore
5. Grup moshat për nxënësit që marrin dëftesë lirimi , pjekurie dhe diplomë
6. Përfundimet vjetore në të gjitha nivelet arsimore
7. Të dhënat për arsimin jo-publik
8. Numri i studentëve të huaj

Etapa e III

Më pas u përcaktuan treguesit e parë ,për të cilat egziston baza e të dhënave statistikore.

Indikatorët dhe nën indikatorët e OECD për të cilët mendojmë se disponojmë bazën e të dhënave po i rendisim sipas kapitujve si më poshtë:

Kapitulli A

Përmbajtja demografike, sociale dhe ekonomike e arsimit

A1/1 Shpërndarja e popullsisë 25-64 vjeç sipas nivelit arsimor të kryer

A1/2a Përqindja e popullsisë që ka kryer jo më pak se arsimin e mesëm

A1/2b Përqindja e popullsisë që ka kryer arsimin e lartë

A4/1 Përqindja e popullsisë 5-14 vjeç në totalin e popullsisë

A4/2 Ndryshimi i popullsisë së re dhe parashikimi deri në 2006.

Kapitulli B

Burimet financiare dhe humane të investuara në arsim

- B1/1** Shpenzimet në institucionet arsimore si % e GDP sipas burimit të financimit
- Parauniversitar
 - Universitar
- B1/2** Indeksi i ndryshimit midis viti 1990 dhe 1995 të shpenzimeve direkte të shpenzuara në arsim në raport me GDP.
- B1/3** Shpenzimet për kërkim dhe zhvillim në raport me GDP(1995)
- B2/1** Shpenzimet publike në arsim si % e shpenzimeve totale publike
- Parauniversitar
 - Universitar
- B4/1** Shpenzimet vjetore për 1 student në institucionet publike dhe private
- B4/2** Indeksi i ndryshimit të shpenzimeve në arsim, të rregjistruarit dhe shpezimet për një student
- Parauniversitar
 - Universitar
- B5/1** Shpërndarja e shpenzimeve totale dhe shpezimeve korrente për student sipas kategorisë së burimit
- Parauniversitar
- B5/2** Mesatarja e shpenzimeve korrente për student sipas kategorisë së burimit
- Parauniversitar
 - Universitar
- B6/1** Shpenzimet në arsim sipas nivelit të Qeverisjes në sistemin
- Parauniversitar
 - Universitar
- B7/1** Raporti studentë mësues sipas niveleve
- Parauniversitar
 - Universitar

Kapitulli C

Pjesmarrja e përgjithshme në arsimin e rregullt

- C1/2** Raporti neto i të rregjistruarve me vite për të gjitha nivelet e arsimit
- C1/3** Kalimi nga arsimi i mesëm në arsimin e lartë për grup moshën 17-20 vjeç
- C2/1** Raporti i të diplomuarve sipas grup moshës krahasuar me grup moshën përkatëse të popullsisë
- C2/2** % e nxënësve të rregjistruar në arsimin profesional krahasuar me grupmoshën përkatëse në arsimin me kohë të plotë
- C3/1** Raporti i pranimit të studentëve në sistemin me kohë të

- plotë dhe të shkurtuar
- C3/4** % e studentëve universitarë me kohë të plotë dhe atyre mbi 25 vjeç
- C3/5** Shpërndarja e studentëve në arsimin e lartë sipas llojit të institucionit
- Publike
 - Jo publike me varësi nga shteti
 - Të pavarura nga shteti
- C4/1** Raporti i universiteteve sipas kohë zgjatjes së programit
- C4/2** Raporti i diplomimeve në arsimin e lartë me grup moshën përkatëse të popullsisë.
- C4/1** Shpërndarja e përqindjes që zë çdo grupfushë në arsimin e lartë
- C6/1** Fëmijët me nevoja të veçanta sipas kategorisë A,B,C

Kapitulli D

Kalimi nga shkolla në punë

- D1/1** Statusi në arsim dhe punë të popullsisë 15-19 vjeç, 20-24 vjeç, 25-29 vjeç
- D1/2** % e popullsisë së re jo në arsim sipas gjinisë
- D2/1** Zgjatja në vite në arsim dhe punë të moshës 15-29 vjeç të popullsisë dhe sipas gjinisë
- D4/1** % e papunësisë së popullsisë së re sipas nivelit arsimor, moshës dhe gjinisë

Kapitulli E

Paga bazë e mësuesve në arsimin 8 vjeçar dhe të mesëm

- E1/1** Paga bazë vjetore e mësuesve fillestare dhe ajo pas 15 vjetësh
- E1/2** Ndryshimi i pagës vjetore pas 15 vjetësh e krahasuar me ndryshimin e GDP.
- E2/1** Shpërndarja e mësuesve sipas grupmoshave në arsimin 8 vjeçar
- E2/2** % e femrave në stafin mësimor sipas niveleve të arsimit
- E3/1** Numri i orëve të mësimit për një vit në institucionet publike sipas nivelit arsimor
- E4/1** Raporti i orëve mësimore të shkencave të natyrës kundrejt atyre gjithsej
- E4/2** Raporti i orëve mësimore sipas fushave krahasuar me totalin
- E5/1** Shpërndarja e marrjes së vendimeve sipas nivelit të qeverisjes
- E6/1** Numri i nxënësve për kompjuter në shkollë në arsimin 8 vjeçar
- E6/2** Shpërndarja e frekuencës së përdorimit të kompjuterit në shkollë dhe shtëpi ; Ditore, javore, mujore, rrallë, kurrë.

Kapitulli F

Arritjet e nxënësve dhe kalimet në tregun social dhe atë të punës

F1/1 Arritjet matematikore të nxënësve të klasës së IV-t dhe të VIII-të krahasuar me përcaktimin e **OECD**

F5/1 Forcat e punës për popullsinë 25-64 vjeç sipas nivelit arsimor dhe gjinisë

F5/3 Papunësia e popullsisë 25-64 vjeç sipas nivelit arsimor dhe gjinisë.

Etapa e IV

- **Në njohjen e tabelave UOE** (Pyetsori elektronik botim OECD Janar 2001) në të cilat futen të dhënat.
- **futjen e të dhënave të mbledhura në tabelat UOE** dhe dërgim në OECD nëpërmjet “Data collection”.
- Me raportimin në OECD të të dhënave përfundon puna me këtë organizëm të rëndësishëm ndërkombëtar.

Më pas puna mund të vazhdojë në kuadrin e institucioneve të mësipërme vëndase me:

- **Sigurimin e formulave, programeve , Soft-ve të cilat perdor OECD** (eksperiencë që është realizuar me EUROSTAT)
- **Përlllogaritja e indikatorëve të zgjedhur**
- **Botimi i këtyre indikatorëve të llogaritur dhe shpërndarja** në institucione të arsimit dhe më gjerë, duke shpjeguar në të:
 - a) Metodologjinë e indikatorit
 - b) Specifikën e vendit
 - c) Shtrirjen e tij
 - d) Përmbledhje
 - e) **ISCED (Standarti Ndërkombëtar i Niveleve të Arsimit).**
 - f) Anekset
 - g) Referencat bazë të të dhënave
 - h) Paraqitje grafike të treguesit.

ISCED-1997
KLASIFIKIMI STANDART NDËRKOMBËTAR I ARSIMIT

Ç'ËSHTË ISCED-97

ISCED-97 është një mjet i përshtatshëm për grumbullimin, hartimin dhe paraqitjen statistikave të arsimit, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

ISCED-97 jep tendencat e zhvillimit të mëtejshëm të arsimit në rajone të ndryshme të botës.

Ai siguron:

- Shtimin e formave të ndryshme të mësimdhënies në arsimim dhe trainim.
- Shtimin e specialiteteve të personelit mësimdhënës
- Rritjen e interesimit ndaj shkollimit në distancë bazuar në të gjitha mundësitë që japin teknologjitë e reja

ÇFARË MBULON ISCED-97

- ISCED mbulon të gjithë organizimin dhe përballimin e sistemit mësimdhënës në nivele të ndryshme, për fëmijë, të rinj dhe të rritur, duke përfshirë dhe ato me kërkesa të veçanta arsimore të nevojshme për institucionet dhe për mbajtjen e tyre në nivelin dhe formën në të cilën ato zhvillohen.
- ISCED siguron një skelet të integruar dhe të qëndrueshëm statistikor për mbledhjen dhe raportimin e statistikave të krahasueshme ndërkombëtare të arsimit.
- Njësia themelore e ISCED mbetet programi statistikor. Programet e arsimit janë përcaktuar në bazë të përmbajtjes së tyre arsimore si dhe një rradhitje e aktiviteteve arsimore të cilat janë organizuar për të përmbushur një objektivi të paravedosur ose një drejtim të specifikuar të detyrave arsimore.
- **Ndërthurja e variablave të klasifikimit.** Programet arsimore janë ndërthurje klasifikimesh nga nivelet dhe fushat e arsimit me kodet e tyre përkatëse. Këtu përfshihen:

- 6 nivele arsimi
- 9 grupe të mëdha fushash
- 25 grupe mesatare fushash
- 80 grupe të detajuara fushash arsimi dhe trainimi.

PËRMBAJTJA

Nivelet e arsimit sipas ISCED-97 janë :

- 0 - Niveli i arsimit parashkollor
- 1- Niveli shkollor i arsimit (Arsimi bazë)
- 2- Niveli i ulët i arsimit të mesëm (2A,2B,2C)
- 3- Niveli i lartë i arsimit të mesëm (3A,3B,3C)

- 4- Niveli pas arsimit të mesëm, jo i lartë (4A,4B,4C)
- 5- Stadi i parë i arsimit të lartë (5A,5B)
- 6- Stadi i dytë i arsimit të lartë

PËRDORIMI I ISCED-97 NË SHQIPËRI

Në statistikat shqiptare të arsimit ISCED-97 është përdorur për herë të parë në 1998. INSTAT dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës morën pjesë në projektin “Tregues të arsimit në vendet e PHARE-it, në 1996-97”. Informacioni i përpunuar u shpërnda dhe u bë i njohur në të gjitha rrethet.

INSTAT zbaton në detaje këtë klasifikim në të gjithë informacionin statistikor përkatës, duke u bazuar në informacionin e marrë sipas të njëjtës strukturë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës si dhe Drejtoritë Arsimore të rretheve në të gjitha nivelet.

CFARE ESHTË PROGRAMI PISA
(PROGRAMI PER VLERESIMIN NDERKOMBETAR TE
NXENESVE)

Perparim Shera, Qendra Kombetare Vleresimit

Programi per vleresimin nderkombetar te nxenesve eshte nje projekt i Organizates per Zhvillim dhe Bashkepunim Ekonomik me qellim nxjerrjen e treguesve nderkombetare mbi aftesite dhe njohurite qe zoterojne nxenesit e moshes 15-vjecare. Tre jane fushat qe vleresohen ne PISA: Matematika, leximi dhe shkenca. Jane parashikuar per tu kryer tre faza testimi. Ne cdo faze dy te tretat e kohes se testimit do ti kushtohen fushes kryesore perkatesisht si vijon: Leximit ne vitin 2001, Matematikes ne 2003 dhe Shkences ne 2006.

PISA ka per qellim te evidentojte se ne cfare shkalle nxenesit qe mbarojne ciklin e detyrueshem shkollor kane pervetesuar disa prej njohurive dhe aftesive qe jane te rendesishme per nje pjesmarrje aktive ne shoqeri.

Nepermjet PISA-s synohet ti jepet pergjigje ketyre pyetjeve:

- Sa jane te pergatitur te rinjte per te perballuar sfidat e se ardhmes?
- A jane ata ne gjendje te analizojne, arsyetojne dhe komunikojne idete e tyre ne menyre efektive?
- A e zoterojne ata kapacitetin e nevojshem per te vazhduar procesin e te mesuarit gjate jetes?
- A ka menyra te mesuarit dhe shkolla qe jane me efektive se te tjerat?

STUDIMI I PISA 2000-2001

32 vende moren pjese ne studimin PISA 2000 dhe nje numer vendesh te tjera moren pjese ne PISA plus 2001 ne te cilen u perfshi dhe Shqiperia. Ky studim perfshinte si me poshte:

- Dy ore te vleresimit te drejtperdrejte te aftesive te nxenesve nepermjet testeve te leximit, matematikes dhe shkences. Leximi ishte fusha kryesore dhe testi i leximit ishte bazuar mbi nje strukture te re.
- Nje pyetesor vetepletesues 20-minutesh qe iu dha nxenesve per te mbledhur informacion qe ndihmon ne evidentimin e faktoreve qe ndihmojne ne arritjet e nxenesve.
- Nje seksion 3-minutesh mbi teknologjine e informacionit.
- Nje pyetesor shkollor qe iu dha drejtoresve te shkollave per te mbledhur informacion rreth karakteristikave te shkollave.

1012 studente moren pjese ne fazen e pilotimit nga 30 shkolla te zgjedhura dhe afro 5300 studente moren pjese ne fazen kryesore nga 174 shkolla te mesme dhe 8-vjecare me qellim mbledhje te informacionit sipas shperndarjes gjeografike, zonave rurale dhe

urbane dhe llojit të shkollave dhe programit shkollor. Vleresimi u administrua në shkollat perkatese të perzgjedhura në muajt Mars 2001 dhe Nentor 2001 në ditët mesimore.

KUSH E DREJTON PISA-N

Një konsorcium i perbere nga organizata nderkombetare është duke e vene në zbatim projektin nën kujdesin e Organizates për Zhvillim dhe Bashkepunim Ekonomik dhe Bordit të vendeve pjesmarrese të PISA-s. Keshilli australian për kërkim arsimor kryeson konsorciumin që gjithashtu përfshin organizatat e mëposhtme:

- WESTAT Inc, USA
- Institutin Kombëtar për Kërkim Arsimor, Japoni
- Sherbimi arsimor i testimit, USA
- Instituti Kombëtar Holandez për Matjen në Arsim, CITO

Në Shqipëri ky projekt po vihet në zbatim nëpërmjet partnershipit të:

- Fondacionit Sorros
- Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

CFARE TESTOHET NE PISA

Megjithatë fushat e testimit që janë leximi, matematika dhe shkencë i korrespondojnë lendeve perkatese shkollore, ky vlerësim kryesisht nuk do të ekzaminojë se sa nxënësit tane e kanë përvetësuar programin shkollor. Synimi është që të vlerësohet se në çfarë shkalle nxënësit tane kanë fituar njohuritë dhe shprehjet në fushat perkatese për të cilat ata do të kenë nevojë në jetën e mëvonshme.

Lenda e leximit në PISA

Komponenti i aftësive në fushën e leximit kërkon nga nxënësit të kryejnë një varg detyrash me lloje të ndryshme tekstesh të dhena. Keto detyra përfshijnë gjetjen e të dhënave specifike për të demonstruar aftësinë e të kuptuarit të gjere dhe të interpretimit të tekstit dhe reflektimit mbi përmbajtjen dhe vecoritë e informacionit të dhene.

PISA i vlerëson aftësitë baze të leximit duke patur parasysh tre dimensionet ose komponente:

- Se pari, forma e materialit të leximit, ose tekstit. Shumë vlerësime në "lexim" të nxënësve janë të fokusuar mbi prozën e organizuar në fjali dhe paragrafe, ose tekste të vazhdueshme. Përveç kësaj, PISA përfshin tekste diskrete të shkeputura që prezantojnë informacion në rrugë të tjera, si për shembull në lista, forma, grafike apo diagrama. Dallime gjithashtu janë bërë midis një shumëllojshmërie të formave në formë prozash, si për shembull tregimi, ekspozimi dhe argumentimi. Dallime të tilla janë të mbështetura mbi principin që individët do të hasin një shumëllojshmeri formash të shkruara në jetën e mëvonshme, dhe që nuk është e mjaftueshme që të jesh në gjendje të lexosh një numer të kufizuar të llojeve tipike të teksteve të paraqitura në shkollë.
- E dyta, tipi i detyrës së dhene në fushën e leximit. Kjo i korrespondon në një anë shprehjeve të ndryshme konjitive që nevojiten për të qenë një lexues efektiv, dhe në anën tjetër, karakteristikave të grupeve të pyetjeve në vlerësim. Nxënësit nuk vlerësohen në pjesën më të madhe të aftësive baze në lexim, sepse presupozohet që pjesa më e madhe e 15-vjeçarëve i kanë tashmë të fituara keto shprehje. Për më tepër,

ata pritet te demostrojne zotesine e tyre ne rigjetjen e informacionit te dhene, formimin e te kuptuarit te pergjithshem te tekstit, interpretimin e tij, reflektimin mbi permbajtjen dhe formen e teksteve ne lidhje me dijet e tyre vetjake mbi boten qe na rrethon, dhe argumentimin sipas pikpamjeve te tyre dhe fushes se tyre te vezhgimit.

- E treta, vlera apo dobia per te cilen teksti eshte ndertuar, pra konteksti i tij ose situata. Per shembull nje novele, leter personale ose biografi eshte shkruar per qellime "private" te njerezve; dokumenta zyrtare ose shpallje per qellime "publike"; nje manual ose raport per qellim "punesi"; dhe nje tekst ose flete pune per qellim "edukativ". Nje arsye e rendesishme per perdorimin e ketyre elementeve eshte qe disa individe mund te veprojne me mire ne nje situatë leximi se ne nje tjetër. Pra, eshte e deshirueshme te perfshish nje shumellojshmeri tipesh te leximit ne kerkesat e vleresimit.

Lenda e matematikes ne PISA

Aftesite baze matematike perfshijne perdorimin e kompetencave matematike ne disa nivele, qe nga performanca e veprimeve standarde matematike deri ne te menduarin dhe vezhgimin matematik. Ajo kerkon gjithashtu njohuri dhe zbatime nga nje pjese e permbajtjes lendore matematike.

PISA vlereson aftesite baze matematike te nxenesit ne tre dimensione:

- E para, permbajtja apo brendia matematike, e percaktuar kryesisht ne koncepte te gjera matematike te fshehura nen te menduarin matematik (si per shembull mundesia, ndryshimi dhe rritja, hapësira dhe forma, arsyetimi, lidhjet e varuara dhe te ndryshueshme), dhe vetem me pas ne lidhje me ceshtjet kurrikulare (si per shembull numrat, algjebra dhe gjeometria). Vleresimi PISA, ne te cilen matematika eshte nje fushe minore, fokusohet ne dy koncepte: ndryshimi dhe rritja, dhe hapësira e forma. Keto dy fusha lejojne nje prezantim te gjere te aspekteve te kurrikulimit.
- Se dyti, perpunimi matematikor i percaktuar prej kompetencave te pergjithshme matematike. Keto perfshijne perdorimin e gjuhes matematike, modelimit dhe aftesive te zgjidhjes problemore. Ideja nuk eshte megjithate per ti vecuar aftesi te tilla ne kerkesa te ndryshme te testit, duke qene se presupozohet qe disa kompetenca do te nevojiten per te kryer cdo detyre matematike. Per me teper, pyetjet jane te organizuara ne tre klasa kompetencash duke percaktuar llojin e shprehise se te menduarit te nevojitur.
 1. Klasa e pare e kompetencave te perbera nga llogaritje te thjeshta ose percaktimeve te tipit me te zakonshem ne vleresimet matematike konvencionale.
 2. Klasa e dyte qe kerkon lidhjet qe duhen bere per te zgjidhur probleme te sakta.
 3. Klasa e trete e kompetencave perbehet prej te menduarit matematik, pergjithesimit dhe vezhgimit, dhe kerkon qe studentet te perfshihen ne analize, te identifikojne elementet matematikore ne nje situatë te dhene dhe te formulojne problemat e tyre.
- E treta, situatat ne te cilat matematika perdoret, duke variuar nga konteksti privat ne ato qe kane te bejne me ceshtje me te gjera publike dhe shkencore.

Lenda e shkences ne PISA

Aftesite baze ne shkenca perfshijne perdorimin e koncepteve baze te shkences me qellim kuptimin dhe ndihmen ne marrjen e vendimeve rreth botes natyrore. Ato

gjithashtu përfshijne të qenurit në gjendje për të njohur të panjohurat e shkencës, përdorur të dhenat, nxjerrë konkluzione shkencore dhe komunikuar këto konkluzione. Konceptet shkencore të përshtatshme me botën e nxënësve do të përdoren tani dhe në të ardhmen e afërt. PISA i vlerëson aftësitë bazë në shkencë në tre dimensione:

- Se pari, konceptet shkencore, të cilat janë të nevojshme për të kuptuar fenomene të caktuara të botës që na rrethon dhe ndryshimet e bërë në të nga veprimtaria njerëzore. Ndërsa konceptet në PISA janë të ngjashme me ato të shkencave të fizikës, kimisë dhe biologjisë, dhe shkencës së tokës dhe hapësirës, është e nevojshme të aplikohen probleme shkencore të jetës reale se sa thjesht vetëm të kujtuarit. Përbajtja kryesore e vlerësimit zgjidhet nga tre fushat e gjera të aplikimit: shkencë e jetës dhe shëndetit; shkencë e tokës dhe mjedisit dhe shkencë në teknologji.
- Se dyti, proceset dhe përpunimi shkencor, i cili fokusohet mbi aftësinë për të njohur, interpretuar dhe vepruar mbi të dhenat. Pese procese të tilla janë prezente në PISA në lidhje me:
 - Kuptimin e kërkesave shkencore.
 - Identifikimin e të dhenave.
 - Nxjerrjen e konkluzioneve.
 - Komunikimin e këtyre konkluzioneve.
 - Demonstrimin e të kuptuarit të koncepteve shkencore.

Te gjitha këto përveç të fundit nuk kërkojnë një masë të paracaktuar dijeshe shkencore. Duke qenë se ende asnjë proces shkencor nuk mund të jetë i pavarur nga përbajtja, kërkesat e shkencës në PISA gjithmone kërkojnë të kuptuarin e koncepteve bazë shkencore.

- Se treti, situatat shkencore, të zgjedhura kryesisht nga jeta e përditshme e njerëzve se sa nga praktika e shkencës në klase apo laborator, ose puna e shkencëtarëve profesioniste. Si me matematikën, shkencë figuron në jetën e njerëzve që nga situatat private apo personale deri në ato me gjëra, publike apo nganjehere edhe ato globale.

AKTIVITETET E KRYERA PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË PISA-S

1. Përzgjedhja e shkollave për testim.

- Mbledhja e të dhenave statistikore për shkollat. (Qendra kombëtare)
 - Numri total i nxënësve 15-vjeçarë.
 - Vendndodhja sipas prefekturave.
 - Urbanizimi (qytet apo fshat).
 - Tipi i shkolles (publik apo privat).
 - Programi i shkolles (i përgjithshëm, profesional).
- Përcaktimi i shkollave dhe i masës së nxënësve për testim për çdo shkollë (Konsorcium)
 - Stratifikimi i shkollave sipas zonave prefekturale, urbanizimit dhe programit të shkolles.
 - Përcaktimi i shkollave të mëdha (mbi 35 nxënës 15-vjeçarë), të vogla (17-35 nxënës) dhe shumë të vogla (nën 17 nxënës) sipas numrit të nxënësve.
 - Zgjedhja e shkollave për testim (174 shkolla).
 - Përcaktimi i masës së nxënësve për testim sipas madhësisë së tyre përkatesisht, 35-shkollat e mëdha dhe të vogla, 17-shkollat shumë të vogla.

- Njoftimi i shkollave pjesmarrese, konfirmimi dhe zevendesimi i shkollave refuzuese. (Qendra Kombetare).
2. Caktimi i koordinatorëve të shkollave. (Qendra kombetare)
 3. Perktimi i instrumentave dhe manualeve të testit (Qendra kombetare) dhe rishikimi i tyre (Konsorcium).
 4. Perzgjedhja e nxenesve për testim. (Qendra kombetare)
 - Dergimi në shkollë dhe përgatitja e listës së studentëve të pranueshëm për testim
 - Hedhja e të dhënave identifikuese të listës së studentëve në database.
 - Zgjedhja e rastësishme e nxenesve për tu testuar për çdo shkollë.
 5. Dergimi i listës së studentëve të perzgjedhur për tu testuar dhe instruksioneve për përjashtimin e nxenesve nga testimi i shkollave përkatëse. (Qendra kombetare)
 6. Caktimi dhe trajnimi i administratorëve të testit. (Qendra kombetare)
 7. Shtypja e instrumentave të testit dhe dergimi i tyre në shkollë. (Qendra kombetare)
 8. Korrigjimi i testeve. (Qendra kombetare)
 - Caktimi i korrigjuesve (8-matematike dhe shkence, 16-lexim)
 - Trajnimi i tyre.
 - Korrigjimi i testeve sipas skemës organizative.
 9. Hedhja e të dhënave të instrumentave të testimit në database përkatëse (Qendra kombetare)
 - Të dhënat e pyetësorëve të shkollës dhe të nxenesit.
 - Përgjigjet e koduara të paketave të testit.
 - Lista e të dhënave të nxenesve të zgjedhur për testim.
 - Rishikimi i të dhënave.
 - Dergimi i tyre në konsorcium.
 10. Analiza statistikore e të dhënave. (Konsorcium)+(Qendra kombetare)

DISA KONKLUSIONE NGA FAZA E PILOTIMIT TE PISA-S NE SHQIPERI

Eshtë e rëndësishme të thuhet se dy fazat e testimit, faza e pilotimit dhe faza kryesore e studimit kanë qëllime të ndryshme. Pilotimi ka dy qëllime kryesore:

- Të mbledhe të dhëna mbi performancën e pyetjeve të testit dhe pyetësorëve për zhvillimin e instrumentave të duhur të studimit kryesor
- Të testojë procedurat operacionale për perzgjedhjen e nxenesve për testim dhe drejtimin e organizimit e vlerësimit brenda shkollave.

Studimi kryesor ka për qëllim vjeljen e të dhënave që do të lejojnë analizën që jep tregues statistikor të vlefshëm mbi popullatën në teresi të nxenesve 15-vjeçarë dhe të shkollave në të cilat ata mesojnë.

Me poshtë paraqiten disa tregues statistikore dhe interpretime të tyre nga të dhënat që u morën nga faza e pilotimit. Keto rezultate janë të kufizuara duke patur parasysh qëllimin e pilotimit. Statistika të thelluara do të publikohen pas studimit kryesor.

Rezultatet e arritjes në përqindje në nivel kombëtar																		
Paketa 1			Paketa 2			Paketa 3			Paketa 4			Paketa 5			Te gjitha			
Matematike	Lexim	Gjithsej	Lexim	Shkencë	Gjithsej	Matematike	Lexim	Gjithsej	Lexim	Shkencë	Gjithsej	Matematike	Shkencë	Gjithsej	Lexim	Matematike	Shkencë	Gjithsej
21%	26%	24%	27%	24%	26%	21%	29%	26%	29%	19%	26%	28%	30%	29%	28%	23%	24%	26%

Tabela 1.

Arritja ne pergjindje per cdo lende ne nivel qyteti dhe fshati				
	Lexim	Matematike	Shkence	Gjithsej
Fshati	23%	17%	21%	21%
Qyteti	30%	26%	26%	28%

Tabela 2.

Arritja ne pergjindje per cdo lende sipas llojit te arsimit				
	Lexim	Matematike	Shkence	Gjithsej
Arsim i pergjithshem	27%	23%	24%	25%
Arsim profesional	38%	35%	34%	37%

Tabela 3.

Treguesit e arritjes sipas llojit te kerkesave

Pyetjet me zgjedhje alternativash			
Matematike	Lexim	Shkence	Gjithsej
36%	37%	42%	38%

Tabela 4

Pyetjet me pergjigje te hapur							
Matematike		Lexim		Shkence		Gjithsej	
Me pergjigje te sakte	Me pergjigje te pjesshme	Me pergjigje te sakte	Me pergjigje te pjesshme	Me pergjigje te sakte	Me pergjigje te pjesshme	Me pergjigje te sakte	Me pergjigje te pjesshme
19%	14%	24%	19%	22%	14%	22%	16%

Tabela 5

6. Pergjindja e arritjes per kerkesat me pergjigje Po/Jo ose "e vertete"/"e gabuar"-31%

7. Pergjindja e arritjes per kerkesat me pergjigje te shkurter-37%.

Nga tabela 1 vihet re qe ne fushen e leximit arritja ne rang kombetar eshte me e larta (28%), ndersa ne matematike me e ulta (23%) midis tre lendeve te testuara lexim, matematike dhe shkence. Testi i leximit ka tregues pothuajse te njejte ne te gjitha paketat, ndersa testi i matematikes dhe i shkences ka tregues te ndryshem ne paketa te ndryshme.

Nga tabela 2 vihet re qe treguesi i arritjes ne teresi tek shkollat e qytetit (28%) eshte me i larte se ne ato te fshatit (21%). Gjithashtu, ky ndryshim vihet re ne cdo lende te testit. Pra, si nxenesit e qytetit dhe ato te fshatit shquhen me teper ne lexim dhe me pak ne matematike.

Nga tabela 3 vihet re se arsimi profesional ka arritje me larte (37%) se arsimi i pergjithshem (25%).

Nga tabelat 4, 5 shikojme se nxenesit kane arritje me te larte per pyetjet me zgjedhje alternativash sesa per pyetjet me pergjigje te hapur.

Nga statistikat deskriptive te pyetjeve te testimi u vu re nje perqindje shume e ulet arritjeje per nje numer te vogel pyetjesh. Ne pergjithesi, krahasuar me treguesit nderkombetare vetem nje numer i vogel pyetjesh figuruan me koeficient veshtiresie me te larte ose me te ulet.

Disa te dhena statistikore dhe konkluzione nxjerre nga pyetesoret e nxenesit:

- Numri i nxenesve pjesmarres-1012, 571-Femra, 441-Meshkuj.
- Rreth 50% e tyre jane nga familje me prinder me arsim te larte dhe rreth 8% pa arsim fare.
- Pjesmarrja e ulet ne aktivite te tilla si: kinema, teater, koncerte muzikore dhe nje pjesmarrje e kenaqshme ne aktivite sportive.
- Tendenca te prinderve per te diskutuar me femijet me teper rreth problemeve te shkolles, librave dhe ushqimit sesa rreth problemeve politive.
- Ndhurma e paket qe prinderit dhe familjaret i tjere i japin femijve mbi detyrat shkollore.
- Mundesite e pakta per akses ne internet (5%).
- Kushte relativisht te mira per te studiuar ne shtepi. 63% kane dhome te tyre, 87% kane vend ku studiojne, 78% kane fjalore, 90% kane libra ne shtepite e tyre etj.
- Mungesa e kompjuterit (81% nuk kane kompjuter)
- Mungesa e mjeteve te komunikimit (65% pa telefon).
- Vetem nje numer i vogel ndjekin kurse te vecanta per permiresimin e rezultateve te tyre. Kryesisht, ndjekin kurse private.
- Mesuesit tregojne interes ne mesim, i nxitin nxenesit te mesojne, i trajtojne mire si dhe i ndihmonje ata sipas mendimit te pjeses me te madhe te nxenesve.
- Numri i madh i nxenesve ne klasa.
- Nxenesit ne pergjithesi e mendojne shkollen si nje ambient ku ata bejne shoke dhe pelqejne te rrine.
- Ekzistenca e nje mase nxenesish qe nuk duan te shkojne ne shkolle (10%)
- Mesuesit nuk bejne vleresime te shpeshta te detyrave te tyre shtepiake dhe nuk merren shume ne konsiderate ne vleresimin e tyre perfundimtar.
- Pjesen me te madhe te kohes merren me detyrat e matematikes dhe te shkences se sa te leximit.
- Pjesa me e madhe e tyre (65%) shpenzojne me shume se 30 minuta per te lexuar per kenaqesi.
- Pjesa me e madhe e tyre pelqejne te lexojne libra dhe e kane per hobi leximin e lire.
- Nxenesit kane libra ne shtepite e tyre (96%).
- Prirja e tyre per te lexuar me teper libra artistike.
- Frekuentimi i kenaqshem i bibliotekave publike dhe shkollore.(86%)
- Mungesa e kompjuterave dhe laboratoreve shkencore neper shkolla.

REZULTATET E PISA-S

Sipas planeve te PISA-s do te kryhet analize statistikore e rezultateve te testit dhe e pyetesoreve dhe PISA do te nxjerre raportet perkatese te treguesve statistikore. OECD ka planifikuar te publikoje gjashte raporte tematike te cilat ofrojne nje analize te thelluar te ceshtjeve specifike, duke perfshire:

- Arritjet dhe background-i social.
- Evidentimi i nevojave te nxenesve me arritje te larta dhe te uleta.
- Arritjet e nxenesve sipas gjinise.
- Arritjet, angazhimi dhe aspiratat, duke kuptuar cfare i ben nxenesit "te gatshem per te mesuar".
- Faktoret shkollore ne lidhje me cilesine dhe drejtesine apo paanesine.
- Nje profil nderkombetar i aftesise se nxenesve ne "Lexim".

Nje raport kombetar mundesisht do te publikohet pas raportit nderkombetar te OECD. Rezultatet nga PISA do te jene te dobishme per specialistet e arsimit, analistet e politikave sociale dhe grupet e tjera te interesuara. Keto grupe kerkimore dhe studiues do te kene mundesi te zoterojne te dhena te rendesishme qe mund te perdoren ne zhvillimin e programeve qe kane te bejne me probleme apo pengesa qe te rinjte mund te perballin ne arsimimin e tyre te metejshe apo ne eksperiencen e punes. Informacioni nga studimi do te ndihmoje per te vleresuar efektivitetin e programeve dhe praktikave ekzistuese, per te percaktuar moshen me te pershtatshme ne te cilen duhen aplikuar keto programe dhe per ti pershtatur ato sipas nevojave te shumices se tyre. Te rinjte vete do te jene ne gjendje te krahasojne arritjet e tyre me ata te brezave me te rinj.

Se fundi, eshte e rendesishme te themi se ky projekt eshte nje eksperience e madhe vecanerisht per vendin tone sepse eshte hera e pare qe kryhet nje vleresim i standardizuar ne Shqiperi. Ky projekt do te kete influencen e vet mbi gjithe popullaten dhe vecanerisht mbi ata qe merren me arsimin per te ndryshuar dhe permiresuar arsimin e te rinjve. Ai do ti lejoje politike-beresit te krahasoje arritjet e sistemit tone arsimor me ato te vendeve te tjera. Rezultatet e tij gjithashtu do te ndihmojne per tu fokusuar dhe motivuar reformen arsimore dhe procesin e permiresimit te shkolles. Ky projekt do te siguroje nje baze per nje vleresim dhe monitorim me te mire te sistemit tone arsimor.

Pergatitur nga
PERPARIM SHERA
 Analisti i te dhenave te projektit PISA

Testet e pranimit në universitet

Rezana Vrapit

Qendra Komëtare e Arsimit dhe Vlerësimit dhe Provimeve

Hyrje

Provimet e pjekurisë janë mbyllja dhe kurorëzimi i formimit të nxënësve dhe një mundësi për të vazhduar studimet e mëtejshme ose për t'iu përgjigjur një niveli të caktuar të tregut të punës.

Në vendin tonë, tashmë ka një traditë në lidhje me kriteret e pranimit të nxënësve në universitet.

Deri para viteve 90', parimi bazë i pranimeve ka qenë mesatarja e notave, e cila u përshkallëzua nga viti i fundit i maturës deri në mesataren e të katër viteve (1988-1989). Rënia ekonomike e vendit, dobësitë e sitemit të kaluar, në mënyrë të padiskutueshme do të ndikonin edhe në sistemin shkollor, ku shumë të rinj e shikonin universitetin si një mundësi për t'i shpëtuar punës së rëndë në fabrika, uzina apo kooperativat e kohës. Në këtë këndvështrim, shkolla dhe mësuesit ishin vazhdimisht nën një presion, atë të notës, gjë që kompromentoi në mënyrë të vazhdueshme nivelin e shkollës dhe të nxënësve.

Pas viteve 90', të ndërgjegjshëm për defektet e mesatares së notës si kriter pranimi në universitet, u kërkuan rrugë të reja më efikase, ku sistemi ynë arsimor t'i shpëtonte ndërhyrjeve të shumta, sidomos në hallkën që lidh shkollën e mesme me universitetin.

Një nga këto rrugë ishte dhe aplikimi i konkurseve nga vetë universitetet, dhe pranimi në këto të fundit u bë mbi një sistem të tillë ku 30% i takonin mesatares së notave të shkollës së mesme dhe 70% vlerësimit mbi bazën e arritjeve në këtë konkurs.

Por edhe kjo mënyrë pranimi nuk i shpëtoi dot ndërhyrjeve të shumta, gati të papërballueshme.

Në vitin 1998 u hartua një proces i ri i pranimit, ai që përdoret edhe sot, i cili u organizua në mënyrë të tillë, që të minimizonte sa më shumë që të qe e mundur ato elemente të proceseve të kaluara, të cilat shikoheshin si më të dyshuarat për ndikime të papërshtatshme. Për këtë arsye ai nuk përfshiu mesataren e notave dhe as provimet e maturës së shkollës së mesme, të cilat influencoheshin aq shumë nga prindërit apo nxënësit.

Ky proces pranimi mbështetet mbi një sistem të ri provimesh të hartuara nga QAKVP dhe nën kujdesin e MASH dhe të prodhuara dhe shpërndara në një nivel të lartë sigurie dhe konfidencialiteti, elemente këto që veçanërisht në pranimet e fundit, të këtij vitij, arritën edhe shkallën më të lartë krahasuar me vitet e mëparshme.

Reformat që janë ndërmarrë në këtë sistem si futja e testeve të sigurta, objektive dhe të standardizuara, kanë ndihmuar në trajtimin e problemeve të korrupsionit në pranimet në shkollat e larta, por megjithatë, në të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që ende mbeten shumë përpjekje për t'u bërë.

Organizimi i provimeve për në universitet

Proçesi i organizimit të provimeve të pranimit për në universitet funksionon duke u mbështetur në një sërë dokumentash të MASH dhe rregullore specifike të hartuara nga QAKVP dhe të aprovuara nga MASH. Bazuar në to organizmi final i provimit është përgjegjësi e universiteteve, QAKVP dhe MASH.

MASH është përgjegjëse për organizimin e përgjithshëm si përcaktimin e datave të provimit dhe procedurave të tjera të përgjithshme. Ajo është organi ekzekutiv që zbaton ligjshmërinë.

QAKVP formulon Testin e Njohurive të Përgjithshme, e shumëfishon dhe ua shpërndan atë fakulteteve në ditën e provimit.

Universiteti është përgjegjës për hartimin e Testit të Specilitetit, administrimin e të gjithë testit, organizimin e konkurimit, zhvillimin e testimit, vlerësimin e përgjigjeve të konkuresve, rivlerësimin dhe shpalljen e rezultateve.

Për organizimin dhe mbarëvajtjen e konkursit titullari i fakultetit ngre këto komisione:

- **Komisioni Qendror** është përgjegjës për të gjithë ecurinë e konkursit.
- **Komisioni i verifikimit** është përgjegjës për procedurat e verifikimit dhe sekretimit.
- **Komisioni i vlerësimit** është përgjegjës për vlerësimin e përgjigjeve të konkurentëve.
- **Komisioni i rivlerësimit** shqyrton ankesat e konkurentëve.

QAKVP në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës ngre një grup të jashtëm për monitorimin e të gjitha procedurave të testimit.

H.

I.

J. Qëllimi i testimit

Testet e pranimit në universitet janë hartuar për të matur njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në lëndë të veçanta me qëllim përzgjedhjeje të tyre për vazhdimin e studimeve në shkollën e lartë.

K. Karakteristikat e testit

Testet e pranimit në universitet janë teste të standardizuara. Ato ndërtohen nga specialistë të vlerësimit në bashkëpunim me specialistë të kurrikulit dhe mësues, si dhe pedagogë të universitetit. Këto teste administrohen dhe korrigjohen në përputhje me procedurave specifike dhe uniforme. Përzgjedhja e pyetjeve bëhet mbi bazën e vlefshmërisë së përmbajtjes duke vlerësuar kështu përmbajtje dhe objektiva specifike të përvetësuara më parë nga nxënësit.

Me anë të këtij testi bëhet krahasimi i çdo nxënësi me nxënësit e tjerë të grupit. Krahasime të tilla janë bërë të mundura për shkak të përshtatshmërisë së normave dhe uniformitetit të procedurave të administrimit dhe korrigjimit (siç e përmenda dhe më lart) që janë karakteristike për teste të tilla.

Testet e pranimit në universitet janë objektive. Veçoritë e pyetjeve të këtij testi bëjnë që vlerësimi i tij të jetë shumë objektiv, pavarësisht se cili e korrigjon dhe sa herë kontrollon ky korrigjim. Në të gjitha rastet vlerësimi do të jetë i njëjtë dhe nuk do të ketë vend për gjykim subjektiv.

L. Zhvillimi i testit

Testi i njohurive të përgjithshme hartohet nga specialistë të QKAVP. Ata bashkëpunojnë me specialistë të kurrikulës, specialistë në fushën e arsimit, mësues të shkollave të mesme dhe kanë për detyrë:

- Të specifikojnë përmbajtjen e testit dhe aftësitë që do të testohen (programin e vlerësimit);
- Të hartojnë tabelën e specifikimeve;
- Të hartojnë fondin e pyetjeve;
- Të ndërtojnë testin sipas niveleve të përcaktuara;
- Të vlerësojnë secilën pyetje për saktësi dhe përshtatshmëri;
- Të rishikojnë secilën pyetje për t'u siguruar se ato i korespondojnë specifikimeve dhe ruajnë një raport të drejtë të temave dhe aftësive.

Testet dhe pyetjet e testit rishikohen nga grupet e specialistëve për të parë saktësinë e simboleve, fjalëve, frazave dhe përmbajtjes dhe nëse shikohen elemente të papërshtatshme ato eliminohen.

Përmbajtja e testit ndërtohet në mënyrë të tillë që të reflektojë natyrën dhe kulturën specifike të shoqërisë sonë.

M. Formatit dhe përmbajtja e testit

Testi i pranimeve në universitet përmban 100 pyetje. Ai është i konceptuar në dy pjesë, me një raport **60% me 40%** ku: **pjesa e parë** i takon njohurive të përgjithshme që nxënësit kanë marrë gjatë shkollës së mesme dhe përbëhet nga 60 pyetje (gjithësej 180 pikë) dhe **pjesa e dytë** i takon testit të specialitetit dhe përbëhet nga 40 pyetje (gjithësej 120 pikë). Kjo pjesë është e hartuar për të provuar njohuritë specifike të marra në shkollën e mesme dhe që janë të përshtatshme për studime universitare në një disiplinë të caktuar.

Nga kjo ndarje janë përjashtuar vetëm Akademia e Lartë e Artit, Arkitektura, Akademia e Sportit dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ku testi vlerëson jo vetëm njohuritë por edhe aftësitë. Si rrjedhim, raporti i mësipërm është ndryshuar në **30% me 70%**, ku 30% i takon testit të Njohurive të Përgjithshme dhe 80% i takon testit të Specialitetit. Meqenëse testi vlerëson edhe aftësitë e nxënësve edhe formati i pyetjeve ka ndryshura, pra nuk përdoren vetëm pyetje objektive, por edhe pyetje të formateve të tjera.

Nuk është bërë ndonjë ndarje kohore midis të dy pjesëve të testit, megjithëse nxënësve iu sugjerohet një ndarje proporcionale e punës midis dy pjesëve. Kjo do t'i ndihmojë ata për të patur rezultate të larta.

Pyetjet në test, për të dy pjesët (NjP+TS), janë pyetje objektive me katër alternativa zgjedhjeje nga të cilat vetëm njëra është e saktë. Krahas katër alternativave me përgjigje, vendoset dhe një alternativë e pestë: e. pa përgjigje.

Testi i njohurive të përgjithshme është hartuar për të matur njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në lëndë të veçanta si dhe aftësitë për të zbatuar ato njohuri.

Përmbajtja e tij reflekton natyrën e kurrikulës së shkollës së mesme. Në të është synuar të përfshihen ato njohuri që mendohen si më të rëndësishmet dhe bazë për të vazhduar studimet në shkollën e lartë.

Ky test përfshin njohuri nga këto lëndë: matematikë, letërsi, fizikë, kimi, biologji, histori, gjeografi dhe shkencat sociale (Njohuri për shoqërinë, Filozofi, Ekonomi e zbatuar).

Testi i specialitetit hartohet dhe zhvillohet nga vetë fakultetet. Pedagogët përpiqen që pyetjet e testit të jenë në përputhje me qëllimet e kurrikulit kombëtar. Kështu që në parim, nxënësit duhet të përgjigjen të gjitha pyetjeve të testit, nëse kanë njohuri të qendrueshme nga kjo kurrikul. Megjithatë, jo gjithmonë ndodh kështu pasi pyetjet shpesh janë tepër të sofistikuar dhe i kalojnë nivelet e njohurive që nxënësit zotërojnë aktualisht.

Pyetjet me zgjedhje në të dy pjesët e testit zakonisht testojnë nivele të tilla si:

- Njohjen e fakteve, termave, koncepteve;
- Kuptimin e informacionit bazë;
- Të shprehin idetë në mënyrë logjike;
- Të analizojnë dhe interpretojnë të dhëna;
- Të interpretojnë grafikë, tabela, formula etj.

Në testin e Njohurive të Përgjithshme pyetjet janë ndërtuar sipas tre niveleve të Taksonomisë së Blumit: **njohjes, të kuptuarit dhe zbatuarit**. Pesha që zë çdo nivel në testin e Njohurive të Përgjithshme është:

- **Niveli i njohurive** **40%**
- **Niveli i të kuptuarit** **40%**
- **Niveli i zbatimit** **20%**

Në këtë mënyrë sigurohet që niveli i vështirësisë së testit të Njohurive të Përgjithshme, në ditë të ndryshme të testimit të jetë i njëjtë. (Megjithëse kjo ende nuk është provuar si pasojë e mungesës së paratestimit të fondit të pyetjeve).

Në testin e Njohurive të Përgjithshme, shpërndarja e pyetjeve sipas lëndëve është bërë duke u bazuar në numrin e orëve që këto lëndë kanë në programin mësimor të katër viteve të shkollës së mesme dhe konkretisht:

N. Lënda	Numri i pyetjeve
Matematika	12
Letërsi	11
Fizikë	8
Kimi	7
Histori	7
Biologji	6

Gjeografi	6
Shkenca sociale	3

O. Vlerësimi

Testi i pranimit në universitet ka një total prej 300 pikësh. Për çdo përgjigje të saktë nxënësit marrin tre pikë. Penalizimi i tyre ndodh në këto raste:

1. Nxënësit marrin 1 pikë më pak kur: rrethojnë alternativën e gabuar, rrethojnë dy ose më shumë alternativa, kur rrethojnë tri herë alternativën “e” (pa përgjigje);
2. Nxënësve iu hiqen 3 pikë kur nuk kanë rrethuar asnjë alternativë;
3. Nxënësit nuk marrin asnjë pikë kur rrethojnë alternativën “e” (pa përgjigje).

Për nxjerrjen e pikëve për çdo nxënës, korrigjuesi i testit përdor një formulë të caktuar.

Korrigjimi i testit bëhet nga një komision i ngritur nga vetë fakulteti. Por komisioni duhet t'i kryejë të gjitha procedurat e vlerësimit në përputhje me rregullat e vendosura nga QAKVP.

P. Administrimi i testit

Testi i pranimit në universitet zhvillohet vetëm një herë në vit. Fakultete të ndryshme kanë ditë të ndryshme testimi. Kjo kohëzgjatje shkon 6 ditë dhe zhvillohet javën e parë të muajit shtator. Ka shumë nxënës që marrin pjesë në 2-3 teste. Këtë vit numri i studentëve që kanë konkukuruar në të gjitha fakultetet sipas preferencave ka qenë

25 000 (duke patur parasysh se shumë prej tyre konkurojnë 2 ose 3 herë në degë të ndryshme)

- Q. Testi është i formuluar në dy variante A dhe B, të cilat cilat ndryshojnë midis tyre vetëm nga renditja e pyetjeve.
- R. Në shumicën e disiplinave numri i aplikantëve e kalon disa herë numrin e vendeve bosh. Në këtë rast, përzgjidhen për pranim kandidatët me rezultatin total më të lartë. Nëse ka disa kandidatë që janë në kufirin ndarës me të njëjtin numër pikësh, atëherë fiton ai që ka marrë më shumë pikë në testin e specialitetit.
- S.

- **Siguria e testit**

Për vitin 2001, për herë të parë, QAKVP hartoi rregullat e administrimit dhe korrigjimit të testit nën kujdesin e Drejtorisë së Arsimit të lartë në MASH.

Në to janë specifikuar normat e përgjithshme dhe kushtet e testimit; gjithashtu janë dhënë edhe disa udhëzime në lidhje me procesin e testimit: hyrja e kandidatëve në dhomën e testimit, vendosja e tyre, vlerësimi, shpallja e rezultateve etj.

Si rregull ora e fillimit të provimit është 10:00. Testimi zgjat 5 orë. Përpara fillimit të testimit, kandidatët marrin një informacion të detajuar mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë kohës që janë në provim. Në sallën e testimit ndodhet një grup mbikqyrës. Në përbërje të tyre janë pedagogë që nuk japin lëndët që po testohen. Numri i tyre varion nga

numri i kandidatëve. Por në asnjë rast ata nuk janë më pak se dy. Në sallë ndodhet gjithashtu edhe një i dërguar nga QAKVP dhe MASH për monitorimin e të gjitha procedurave të testimit.

Të gjitha këto standarde dhe procedura janë hartuar me qëllim që të gjithë të testuarit në ditën e provimit, të kenë shanse të barabarta për të demonstruar aftësitë e tyre si dhe për të parandaluar të gjithë ata nxënës që duan të përfitojnë avantazhe të pamërituara kundrejt të tjerëve

- **Raportimi i rezultateve.**

Çdo fakultet duhet të raportojë rezultatet e testimit brenda 4 ditëve. Rezultatet afishohen në vendin e caktuar dhe listat përmbajnë pikët në total si dhe pikët që nxënësi ka fituar respektivisht në të dyja pjesët e testit.

T. Procedurat e ankimit

Çdo nxënës ka të drejtën e ankimit kur nuk është dakort me rezultatin e shpallur në listë. Kjo ankesë bëhet me shkrim dhe dorëzohet jo më vonë se dita e shpalljes së rezultatit. Ankimi i bërë shqyrtohet nga Komisioni i Rivlerësimit, i cili e rishpall rezultatin një ditë më vonë. Vendimi i këtij komisioni nuk diskutohet më.

U. Përfundim

Reforma arsimore në Shqipëri mendohet që të japë një kontribut të madh procesin e transformimit shoqëror. Por modernizimi i sistemit arsimor ka nevojë për më shumë asistencë. Një nga mënyrat për ta realizuar këtë qëllim është krijimi i standardeve kombëtare dhe standardeve të vlerësimit në fushën e arsimit. Standarde të tilla do t'i jepnin qeverisë shqiptare mundësinë për të kontrolluar cilësinë në arsim.

Në këtë kohë transformimesh, procedurat e vlerësimeve dhe testimeve duhen përmirësuar në mënyrë serioze. Është e qartë se nëse provimi i përfundimit të shkollës së mesme (maturës) përmirësohet sipas standardeve shkencore, ai do të zëvendësonte normalisht provimin e pranimit në shkollat e larta, duke e lënë në dorë të tyre vendimin për të hartuar një test pranimi ose jo.

Vetvleresimi i shkolles

Vladimir Pasku, Menaxher Projekti, AEDP
Seminari Nderkombetar 6-7 Dhjetor 2001

Zhvillimet bashkekohore ne fushen e arsimit kane evidentuar tendencen e delegimit te pergjegjesise se permiresimit te punes se shkolles tek vete shkolla. Synohet qe stafi i shkolles, komuniteti, pushteti lokal dhe autoritetet arsimore te punojne ne partnership per rritjen e rezultateve te shkolles. Shkolla perfshihet ne nje proces aktiv vetvleresimi, evidenton pikat e forta dhe te metat e saj, vendos objektiva dhe harton plane pune per permiresimin e cilesise se punes se saj. Ne kete menyre, ajo eshte ne gjendje te deklaroje se sa mire i ka punet. Eshte e qarte se ne temel te ketij procesi eshte vleresimi. Nderkaq, ne konceptin e diteve tona, vleresimi perben nje nga fushat me te reja te edukimit. Ai paraqitet po aq kompleks sa dhe objekti i tij. Si i tille ai duhet njohur mire ne menyre qe me pas te dijme si te vleresojme. Ne kete kontekst, do te desheroja te theksoja nje aspekt mjaft te rendesishem te vleresimit:

Ai duhet te sherbeje si baze per nje dialog te hapur midis atyre qe vleresojne dhe atyre qe vleresohen.

Por pse eshte kaq i rendesishem ky dialog?

Sepse dialogu rrit shanset qe vleresimi te behet i dobishem per te dy palet. Ai behet veçanerisht i dobishem per klientet e vleresimit, pra, per shkollat. Nese shkollat perfshihen ne procesin e vleresimit qe do t'u behet qysh ne fillimin e tij, nese ato informohen vazhdimisht per progresin e ketij vleresimi duke bashkevepruar ngusht me vleresuesit, pa dyshim qe ky dialog do te shndrohet ne nje element konstruktiv ne sherbim te permiresimit te shkolles.

Ky eshte konteksti ne te cilin zhvillohet procesi i vetvleresimit ne shkollat tona pilot. Jane bere perpjekje te vazhdueshme per te identifikuar pervalet me te mira boterore, pervalet te cilat mund te ecin ne kushtet e vendit tone. Keshtu, fillimisht jane bere perpjekje per te ecur sipas modelit amerikan te akreditimit te shkolles. Akreditimi i kerkon shkolles te futet ne nje proces permiresimi te vazhdueshem. Por, qe te perfshihet ne kete proces, shkolla, fillimisht, duhet te njihet me standartet qe kerkon ky permiresim. Keshtu, NCA (Shoqata Veriore Qendrore - shoqata me e madhe jo-qeveritare akredituese ne USA qe akrediton me shume se 7000 shkolla te 19 shteteve) ka perpunuar standartet e veta, te cilat mbeshteten ne standartet shteterore dhe jane te njejta per te gjitha shkollat e te njejtës kategori. Ne saj te kesaj psikologjie, mund te thuhet se shkollat e perfshira ne proceset e akreditimit qe ofron kjo agjensi fillojne te mendojne njekohesisht ne dy plane: si te koordinojne sa me mire punen qe bejne per realizimin e standarteve shteterore me punen qe duhet te bejne per realizimin e standarteve te agjensise akredituese. Shkollat e kerkojne vullnetarisht perfshirjen ne procesin e permiresimit dhe te vleresimit te tij se tyre nga agjensia. Ky fakt perben nje element shume te rendesishem te akreditimit. Pra, nese shkollat duan te **vetperfshihen**, e theksojme, te **vetperfshihen** ne procesin e permiresimit, detyrimisht ato duhet te ballafaqohen me standartet e agjensise

akredituese. Ky ballafaqim duhet te provoj se shkolla ose i ka pranuar keto standarte ose i ka tejkualuar (kapercyer) ato. Pra, thelbi i akreditimit eshte:

Arritja ose tejkalimi i standarteve te vendosura nga nje organizem i jashtem. (2)

Por ky lloj vetvleresimi eshte mjaft i kushtueshem per kushtet e vendit tone. Ai presupozon egzistencen/krijimin e NGO te fushes se akreditimit dhe perfshirjen ne proces te universiteteve dhe te nje numri te madh specialistesh te fushes se vleresimit.

Pervoja izraelite ofron grupe shkollash te cilat perfshihen vullnetarisht ne nje proces vetvleresues. Mbeshtetur ne kerkesat e standardeve shteterore dhe ne perputhje me karakteristikat e tyre, shkollat perdorin indikator, instrumenta dhe teknika te ndryshme vleresuese per te pare se si punojne per arritjen e objektivave qe ato kane vendosur. Ekspertet izraelite mbrojne pikpamjen se imponimi i treguesve qe duhet te perdor shkolla per vetvleresim i kufizon perpjekjet e saj.

Hollanda ofron nje numer te madhe indikatoresh te cilet mund te perdoren nga shkollat e perfshira ne procesin e vetvleresimit. Por, procesi kercenohet nga rreziku i burokratizimit sepse stafi mund te humbas objektivin duke harxhuar shume kohe dhe energji me zgjedhjen e indikatoreve qe duhen perdorur ne kete apo ate rast.

Sistemi arsimor ofron nje sistem te plote indikatoresh, i cili tashme eshte provuar si i suksesshem. Nderkaq, kemi vene re se ne te gjenden elemente pune me te cilet shkolla jone eshte perballur. Nga ana tjeter, pilotimi i deritanishem tregon se pervoja skoceze ka pak nga te gjitha pervojat e mesiperme. Keshtu, shohim se shkollat pilote ose nuk jane te qarta per strukturen e indikatoreve qe perdorin, ose ndjehen te kufizuara ose vazhdojne te veprojne sipas rutines se perditshme.

Cili eshte thelbi i sistemit skocez te vleresimit?

Ne pergjithesi, njerezit reflektojne ndaj cilesise se shkollave ne nivel lokal dhe ndaj arsimit ne nivel kombetar. Raportet e inspektimit te MASH, te drejtorive arsimore dhe te drejtoresh te shkollave kerkojne qe, ne shkalle kombetare apo lokale, t'i pergjigjen pyetjes “*Sa i mire eshte Arsimi Shqiptar?*” Ky material synon te ndihmoje te gjithe mesueset per t’iu afruar sa me shume pergjigjes se pyetjes “*Sa e mire eshte shkolla jone?*”

Nga ana tjeter, mendimi qe kemi per cilesine ndryshon sa here qe ne shoqeri ndodhin ndryshime. Natyrisht, shkollat kane pergjegjesi para shoqerise per cilesine e punes se tyre dhe ne, si mesues, jemi te perfshire ne synime dhe politika te bashkevendosura per te rritur te nxenit e nxenesve. Duke kryer kete pune ne i referohemi:

- Nevojave te nxenesve tane dhe te komunitetit te cilit i sherbejme;
- Udhezimeve nga autoritetet lokale dhe kombetare;
- Raporteve per arritjet e mesimdhencies dhe te

mesimnxenies efektive.

Por, kur nje shkolle eshte e mire?

Nje shkolle eshte e mire nese ajo ka te qarte:

- Çfare synon te beje;
- Nese po i arrin objektivat e saj me sukses;
- Sukseset qe duhen ruajtur dhe problemet qe duhen permiresuar;
- Nese po ndodhin ndryshime.

Nese shkolla i njej keto çeshtje dhe vepron mbi to, atehere mund te thuhet se ajo eshte ne rruge te mbare dhe tashme ka nje sistem te mire te ruajtjes se cilesise se saj. Kjo eshte arsyeja se perse vetvleresimi i shkolles eshte ne zemer te ruajtjes te cilesise.

Çfare eshte vetvleresimi i shkolles?

Vetvleresim do te thote te pyetesh vetveten p. sh.:

- Si po punojme ne shkollen tone?
- Si po punojme ne klasen tone?
- Si po veprojmë ne grupin tone te lendeve?

Ai perfshin:

- Nje tablo te gjere per arritjet ne ato qe konsiderohen si fusha themelore. Fushat themelore jane: (1) Kurrikula; (2) Arritjet; (3) Mesimdhenia dhe Mesimnxenia; (4) Mbeshtetja e nxenesve; (5) Etika; (6) Burimet dhe (7) Drejtimi d.m.th. udheheqja dhe sigurimi i cilesise.
- Nje tablo te kufizuar ne fusha specifike qe konsiderohen si te sukseshme ose qe kane probleme.

Nxitja per te marr nje tablo te kufizuar mund te vij nga: nje çeshtje e identifikuar ne tabllone e gjere; nje cikël i rregullt vleresimi gjate te cilit eshte rishqyrtuar puna e shkolles; probleme te perbashketa me shkollat ose me biznesin lokal; objektivat lokale ose kombetare; pikpamjet e prinderve si dhe nga inspektoret.

Shkollat, duke vetvleresuar te gjitha fushat themelore gjate disa viteve, aftesohen per te pare problemet qe duhen permiresuar apo sukseset qe duhen ruajtur. Kete gje ato e kryejne nepermjet perdorimit te mjeteve te qarta per matjen e suksesit. Plani i punes apo i zhvillimit perfaqeson nje rruge te mire per vetvleresimin e shkolles.

Pse eshte i rendesishem plani i zhvillimit?

Ju duhet te planifikoni nese doni te dini se si jeni duke punuar dhe se si po ecni. Ky eshte nje parim i pranuar nga te gjithë. Prandaj, plani i punes:

- Nxit mesimdhënie dhe mesimnxenie efektive;
- Mundeson drejtimin dhe monitorimin e ndryshimeve nga ata qe i zbatojne;
- Ndhmon te jemi realist gjate vendosjes se prioriteteve, objektivave dhe afateve;
- Inkurajon perdorimin e buxhetit te shkolles ne menyren me te mire.

Vetvleresimi nepermjet plani te zhvillimit te çon tek ruajtja e cilesise.

Çfare eshte ruajtja e cilesise?

Ruajtja e cilesise prek te gjithë aspektet e jetes se shkolles. Ajo perfaqeson cilesine ne kuptimin e plote dhe jo cilesine e pakontrolluar. Ajo ka te beje me vendosjen e nje etike e cila synon realizimin e punes me te mire te mundshme ne shkolle. Duke e trajtuar ruajtjen e cilesise ne kete koncept dhe ne menyren se si veprojmë, mund te themi se ruajtja e cilesise perfaqeson pergjegjesine e mesuesve dhe te stafit te shkolles te mbeshtetur nga prinderit, autoritetet lokale dhe inspektorët per permiresim te dukshem te cilesise ne shkolle. Duke punuar se bashku, ne mund te realizojme nje permiresim te dukshem te cilesise se arsimit shqiptar.

Ku ndryshon vetvleresimi i shkolles nga vleresimi i saj prej inspektoreve?

Ne kemi nevojë per nje vleresim te jashtem per te kontrolluar se si po ecim. Vleresimi dhe kontrolli i arritjeve ne shkollat shqiptare ne shkalle kombetare eshte detyre e inspektoreve te niveleve te ndryshme. Ketu nuk ka asgje mistike: vleresimi prej tyre mbulon po ate fushe qe mbulon edhe vetvleresimi i shkolles dhe synohet te kryhet nepermjet perdorimit te indikatorëve njejte te arritjeve ne diskutimet me shkollat dhe mesueset.

Prandaj eshte e qarte se vetvleresimi i shkolles dhe vleresimi i jashtem, ndersa i sherbejne qellimeve te ndryshme, perforcojne angazhimin e ne te gjithëve per te vleresuar ate qe po kryejme. Vetvleresimi i shkolles dhe vleresimi i jashtem, i kryer nga autoritet mesimore apo nga inspektorët, shqyrton prioritetet e shkolles, standartet dhe arritjet ne fushat themelore te cilave iu referuam me siper. Shkollat dhe autoritet arsimore mund ta kryejne nje gje te tille duke shtruar te njejtat pyetje si dhe inspektorët:

Sa mire po ecin nxenesit?

Sa mire po drejtohet shkolla?

Sa efektive eshte shkolla?

Atehere: si ta bejme vleresimin nje element sa me te dobishem te punes se shkolles?

Ne mund te njohim se çfare jemi duke kryer nepermjet krahasimit te arritjeve tona me parashikimet te cilat jane te shprehura ne objektivat e shkolles. Ne te kaluaren, me te drejte, kemi shqyrtuar pasqyren e aktiviteteve te klases dhe te vleresimeve te shkolles. Por, eshte e nevojshme qe te shqyrtojme edhe tabllone qe ka lidhje me objektiva me te gjera. Nje gje e tille mund te behet duke perdorur indikatoret e arritjes, te plotesuar edhe me rezultatet e provimeve.

Indikatoret e arritjes ne pergjithesi perfaqesojne mates te atyre faktoreve te cilet influencojne ne efektivitetin e te nxenit te nxenesve dhe mbi te cilet shkollat kane mundesi kontrolli.

Ata ndihmojne:

- Si te matim arritjet sipas nje grupi kriteresh;
- Si te identifikojme fushat ku kerkohej nje analize e hollesishme;
- Aftesimin e drejtuesve te shkollave per te marr vendime per sukseset dhe dobesite e dites ne procesin e zhvillimit te shkolles.

Indikatoret e arritjes mund te na ndihmojne per te vleresuar shkallen e realizimit te synimeve. Synimet perfaqesojne objektiva te pergjithshme. Botime te ndryshme te MASH, ISP, etj. perfaqesojne objektivat specifike per fushat kurrikulare, fazat apo çeshtjet e mesimdhenies dhe te nxenit. Bashke me synimet e shkolles, ato ndihmojne kontekstualizimin e indikatorëve te arritjes nepermjet sugjerimit te problemeve qe duhen shqyrtuar. Ata mund te vleresohen sipas kater niveleve te arritjeve te cilet jane pjese integrale e secilit indikator te arritjes.

Plani i punes i shkolles duhet te jete qendror ne kete proces dhe shkolla duhet te perpunoj ne menyre te veçante pjesen e kontrollit. Duhet te synohet te mbulohen te gjitha Fushat themelore gjate nje periudhe tre vjeçare; por, nese nje gje e tille nuk eshte e mundur, ju do te jeni ne gjendje te perdorni konkluzionet e marra gjate perpunimit te tablllose se gjere te arritjeve te shkolles. Mund te ndodh qe per disa aspekte pergjigja ndaj pyetjes "Çfare do te bejme tani?" eshte "Tani per tani asgje". Megjithese jo perfekte, arritja ne kete aspekt mund te konsiderohet e nje standardi te pranueshem dhe aty mund te kete çeshtje qe duhen trajtuar. Ne te gjitha rastet, standartet tuaja dhe raporti per cilesine do te duhet te:

- Te njohin pikat e forta te punes se shkolles;
- Te identifikojne nivelet e sukseseve ne fushat e ndryshme qe duhen ruajtur;
- Te identifikojne nevojat e zhvillimit, te prioriteteve dhe te vendosin objektivat.

Per te vendosur se "Çfare do te bejme tani" eshte mire qe te zgjidhet nje numer i manovrueshem prioritetesh per te cilet mund te identifikohen objektiva specifike te arritshem dhe te matshem: afro 6 per shkollen sekondare, afro tre ose kater per shkollen fillore, departamentet e shkolles sekondare apo njesite speciale. Pika nisesë per prioritetet e zgjedhura duhet te jene synimet e shkolles dhe duhet:

- Te tregojë një balance midis zhvillimit dhe ruajtjes së nivelit;
- Te përfshijë prioritetet lokale dhe kombëtare brenda ciklit;
- Te jetë e lidhur me nivelin e prioritetëve të departamentit/lëndës të shkolles;
- Te orientojë drejt një plani të qartë veprimi.

Raportimi për standartet dhe të cilësisë, tashmë një procedurë e njohur për disa shkolla, duhet të bëhet pjesë integrale e procesit të zhvillimit dhe të vëtvlerësimit. Gjatë procesit duhet të parashikohet të raportohet për një cikël tre vjeçar dhe ky raportim të diskutohet me komunitetin e shkolles.

Ateherë, cilët janë fushat themelore dhe indikatorët e arritjes që përdoren gjatë procesit të vëtvlerësimit?

Ka shtatë fusha themelore që kanë lidhje me aspektet kryesore funksionale të punës së shkolles.

Fushat themelore janë:

Kurrikula

Arritjet

Te nxënit dhe mesimdhënia

Mbështetja e nxënësve

Etika

Burimet

Drejtimi, udhëheqja dhe sigurimi i cilësisë

Indikatorët e arritjes

Secila Fushë Themelore përmban një numër indikatorësh.

P. sh. Fusha: Te nxënit dhe Mesimdhënia ka pesë indikatorë:

3.1 Cilësia e procesit të mesimdhënies

3.2 Cilësia e të nxënit të nxënësve

3.3 Plotësimi i nevojave të nxënësve

3.4 Vlerësimi si pjesë e mesimdhënies

3.5 Komunikimi me prindërit

Temat

Çdo indikator ka disa tema.

P. sh. Indikatorit: Cilësia e procesit të mesimdhënies ka tre tema:

- **Shkalla dhe përshtatshmeria e metodave duke përfshirë edhe punën në shtëpi;**

- **Qartesia dhe qellimshmeria e ekspozimeve dhe shpjegimeve te mesuesve;**
- **Cilesia e dialogut mesues – nxenes.**

Nivelet Cilesia e asaj qe vezhgoni brenda seciles teme mund te vleresohet sipas kater niveleve te arritjes.

Nivelet

4	<i>Shume i mire</i>	- Efektivitet i larte
3	<i>I mire</i>	- Efektivitet më shume së dobesi
2	<i>Mjaftueshem</i>	- Disa dobesi te rendesishme
1	<i>I pakenaqshem</i>	- Dobesi te medha

Ilustrimet

Per shembell: *Cilesia e dialogut mesues-nxenes*

Secila teme eshte e ilustruar ne dy nivele (Niveli4: *Shume i Mire* dhe niveli 2: *Mjaftueshem*) duke treguar çeshtjet pecifike qe duhen trajtuar. Mesueset beshkepunojne efektivisht *me...* Dikutimet e mesuesve me nxenesit nxitin te mesuarit... Kontributet e nxenesve inkurajohen dhe konsiderohen te vlefshem. Pyetjet e mesuesve jane te shkathta dhe pergjigjet e nxenesve... Behet kujdes per te perfshire te gjithë nxenesit. Kur ndeshen veshtiresi ne te nxenit behen perpjekje per...

Sa me siper eshte ajo qe po pilotohet ne 14 shkolla te 11 rretheve.

Projekti "*Vetvleresimi i Shkolles*" eshte pjese e programit per ruajtjen e cilesise se arsimit ne te gjithë vendin. Se bashku me projektet "*Ngritja e Inspektoriatit Kombetar te Arsimit Parauniversitar*" dhe "*Roli i ri keshillimor i Drejtorive Arsimore te Qarqeve*", vetvleresimi i shkolles ploteson tabllone e partnershipit te te gjithë aktoreve te interesuar per ruajtjen dhe permiresimin e cilesise se sistemit tone arsimor. Ne kete menyre, synohet te institucionalizohen veprime te tilla qe e perfshijne arsimin tone ne rrjedhat moderne te zhvillimeve arsimore ne bote.

Projekti "*Vetvleresimi i Shkolles*" filloi te zbatohet ne disa shkolla te vendit tone ne fund te vitit 2000. Ai u parapri nga nje pune e gjate, e kujdesshme dhe profesionale per te kuptuar konceptin e ruajtjes se cilesise, per t'u njohur me pervojat me te mira ne vendet perendimore dhe, pastaj, per te evidentuar ate pervoje qe do te ishte e pershtatshme per kushtet e vendit tone. Moment shume i rendesishem i ketyre zhvillimeve ka qene vizita e stafit drejtues te MASH ne Skoci ne Janar te vitit 2000, vizite e cila shenon fillimin e institucionalizimit te procesit te ruajtjes se cilesise ne arsimin shqiptar. Pjese e ketij

institucionalizimi eshte edhe konsensusi per te zbatuar rreth 20 indikator te arritjes nga 33 te tille qe zbatohen sot ne Skoci.

Viti 2001 shenon fillimin e zbatimit te projektit "*Vetvleresimi i shkolles*". Me shume emocion por edhe me shume optimizem u vendos te fillohej me vetvleresimin *Fushes se Mesimdhenies dhe Te nxenit* nepermjet perdorimit te indikatorit te arritjes *Cilesia e mesimdhenies*. Trajnimet e para deshmuane se procesi i vetvleresimit eshte i mirepritur ne shkollat tona. Ato treguan se ai eshte i veshtire, ai kerkon kohe, energji, burime financiare. Por, e rendesishme eshte se te gjitha kuptuam qe vetvleresimi prek thelbin e procesit te mesimdhenies dhe te te nxenit ne shkolle; se shkolla duhet te jete e ndergjegjeshme per pergjegjesine qe ka per ruajtjen dhe rritjen e cilesise si dhe per ushtrimin e kesaj pergjegjesie; se ajo nuk eshte vetem ne kete proces sepse ne te perfshihen edhe aktore te tjere te cilet shkembejne pervoje me te njejten gjuhe. Shume shpejt doli ne pah se, me shume se arsimor, procesi i vetvleresimit te shkolles perfaqeson nje ndryshim rrenjesor ne psikologji, nje partnership efektiv ku te gjitha mobilizohen per nje cilesi sa me te mire te pergatitjes se femijve tane.

Tashme ne kemi nje pervoje modeste. Tashme kemi grupe mesuesesh qe punojne me passion. Kemi pergatitur nje modul trajnimi per vetvleresimin e cilesise se mesimdhenies i cili mund te perdoret nga çdo shkolle. Jemi duke pergatitur nje modul tjetër për vetvleresimin e *Cilesise se te Nxenit*. Drejtori arsimore te disa rretheve kane vendosur te perfshihen ne procesin e vetvleresimit me nje numer me te madh shkollash. Hapat qe po hedhim po evidentojne domosdoshmerine e bashkepunimit dhe te mbeshtetjes nga institucione profesionale. Nje numer ne rritje ekspertesh te arsimit ofrojne bashkepunimin e tyre. Keta tregues na mbushin me shpresen se jemi ne rruge te mbare.

Pervoja tregon se procesi i permiresimit te shkolles eshte i vazhdueshem: *ne se ai fillon ai nuk ndalet kurre*. Gjate gjithë kohës shkolla do të kalojë neper disa faza te ndryshme te procesit te permiresimit ne perputhje me kushtet e saj duke tentuar rezultate me te larta e per te gjitha nxenesit. *Vazhdimi i procesit eshte me i lehte se sa fillimi i tij*. Sepse tashme shkolla dhe komuniteti kane nje pervoje. Strukturat vetvleresuese funksionojne dhe pergjegjesite e gjithsecilit kane filluar te kuptohen me mire. Po hidhen bazat per nje profil te perpunuar te nxenesit. Pa dyshim qe keta faktore e zvogelojne kohen qe duhet per realizimin e puneve, pra, fillon te rritet rendimenti i perpjekjeve qe ndermerr shkolla.

Si perfundim, shkolla rezulton e perfshire ne nje cikël te vazhduar permiresimi. Dhe natyrisht qe cikli i ri do te jete me i suksesshem se sa ai i meparshmi. Pra, vjen koha qe shkolla te kthehet ne fillim te procesit! Dhe nuk ngelet gje tjetër veç t'i urohet: Suksese ne ciklin e ri!

Bibliografia:

1. David Nevo: School-Based Evaluation. Tel Aviv University, 1995
2. Scottish Office: How Good is Our School?
3. NCA 12 Monographs of Endorsement
4. NCA School Improvement Endorsement

5. AEDP: Modul trajnimi: Cilesia e Mesimdhenies, Tirane 2001